

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7479 E hënë 26 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Për objektivitet dhe saktësi do t'i referohem në këtë shkrim kujtimeve të shkëputura nga libri i Rexhep Rruges, "Stadiumi 'Besa' dhe ngjarjet ..."
Vijon në faqen 20

Nga XHEVAT MUSTAFA

Demonstrata e 26 marsit 1990 në Kavajë, ngjarje që meriton mirënjohje



Opinion i Ditës

Euforia e tanishme e diplomacisë greke dhe maqedonase për zgjidhjen e konfliktit të tyre të vjetër për emrin, duket se bazohet në vullnetin e përbashkët ...
Vijon në faqen 21

Nga SHABAN MURATI

Emri sllav i Maqedonisë - tapi për pronësinë maqedonase



INTERVISTA
Aktor: Pse jam kundër shembjes së Teatrit Kombëtar
Dritan Boriçi: Po i vënë buldozerin "Kadri Roshi", nuk pranoj të gdhitem hoxhë e të ngrysem prift

"S'jam pjesë e bisedimeve, trualli i teatrit është gracka ku shpirti i mbretit kapet si laraska"

Nga FATMIRA NIKOLLI

A e dini se ajo që duan t'i vënë buldozerin te Teatri Kombëtar është salla "Kadri Roshi"? Aktori Dritan Boriçi është një prej atyre artistëve që në muajin shkurt firmosën një peticion ku kërkonte dialog me ministrën e Kulturës ...
Në faqen 9

SA DO TE PAGUJNE SHQIPTARET, MINISTRI KOSOVAR PAL LEKAJ: S'NA PYETEN FARE

SKANDALI, RRUGA E KOMBIT 10 EURO PER 61 KILOMETRA

Opozita kundër, kreu i PD: Do ta shfuqizojmë sa të vijmë në pushtet.
Vasili: Refuzojeni! Kompania koncesionare: Kontrata u firmos nga ju



(Në foto) Sportelet në Rrugën e Kombit

INTERVISTA

Fatos Malaj: Me sa vite qëndrimi do të merret nënshtrësitë në Greqi dhe njohja e pensioneve

Në faqen 8

DEKLARATA NE ILDKP

Sa është pasuria e deputetit të PS-së, që u akuzua se përveç 11 mijë metra tokë

Në faqen 5

AUTORI ALBERT ZEKAJ

Masakroi shokun me çekiç, shoqata fetare: Strehvam vrasësin, nuk e dinim për krimin

Në faqen 7

4500 HA NEN UJE

Përmbijtjet në Shkodër, zyrtari i bashkisë kërkon autonomi: Ia dalim më mirë vetë

Në faqen 6

ALVIN CEKODHIMA: DUHANI SHKAKTON KANCER NE STOMAK



Ylli Merja: Si të shkrihi gurët në tëmth me bimët mjekësore dhe si ta kuptoni sëmundjen

Suplement


Ekskluzive/ Zbulohet raporti sekret i vitit 1973 i sekretarit të parë të Librazhdit

Pse u arrestua Sherif Merdani, fjalët që e çuan në burg

Raporti i Xegës: Armik, thotë se Enver Hoxha duhet ta dorëzojë vetë detyrën

Nga DASHNOR KALOÇI

Menjëherë pas fjalimit të Enver Hoxhës më datat 15 e 16 mars të vitit 1973 në aparatit e Presidiumit të Kuvendit Popullor, ku si objekt dhe temë kryesore ishte: "Lufta ndaj shfaqjeve të huaja e liberale në art e



kulturë dhe ndikimi i tyre në të gjithë jetën e vendit...", fjalim i cili e kishte marrë shtypjen nga Festivali i 11-të Kombëtar i Këngës në Radio-Televizion, që sapo kishte përfunduar në janar të atij viti, në të gjitha institucionet kulturore ...
Në faqen 10-11

TAKSA NE 'RRUGEN E KOMBIT' REAGIMET

Opozita kundër pagesës së tarifës, kreu i PD: Grabitje e dyfishtë

Darina Tanushi

Opozita e kundërshtoi dje, vendosjen e takses në 'Rrugën e Kombit', duke e cilësuar "grabitje të dyfishtë". Kryetari i PD-së, Lulzim Basha u shpreh dje, se kjo taksë veçse është "grabitje e dyfishtë e shqiptarëve është dhe barrierë shtesë mes Shqipërisë dhe Kosovës". Më datën 1 prill 2018 fillon të aplikohet tarifa e pagesës së detyruar në të dy kalimet e 'Rrugës së Kombit' që u ideua, u projektua dhe u ndërtua për të lidhur Shqipërinë dhe Kosovën. Me vendosjen e kësaj tarife, ky projekt merr një goditje të rëndë nga klani kriminal që qeveris sot Shqipërinë", u shpreh dje, Basha. Sipas tij, "Partia Demokratike ka hedhur e para idenë e një studimi tërësor për mundësinë e aplikimit të tarifave të lehta, transparente, të përballueshme nga të gjithë, për të kontribuar kështu në mirëmbajtjen e rrjetit rrugor shqiptar. Por aplikimi i këtyre tarifave do të lidhej me zbatimin e një parimi universal, me ekzistencën e rrugëve alternative, pa pagesë. Do të lidhej po kështu me parimin e mostaksimit të dyfishtë, pra me heqjen e taksës së qarkullimit të automjeteve".

Duke injoruar këtë parim universal, banda që qeveris Shqipërinë, ka dhënë me koncesion aktivitetin e mirëmbajtjes së rrugës së Kombit duke aplikuar një tarifë që shkon nga 10 euro për vajtje-ardhje të një autoveture, në 22.5 euro për dy kalime të një autobusi me dy akse dhe 32.5 euro për autobusët dhe kamionët me tre akse", tha më tej, Basha. "Kjo ndodh në një kohë kur Edi Rama e ka rritur taksën e qarkullimit të automjeteve me 24 lekë për litër karburant. Rritja me 24 lekë për litër, ju merr shqiptarëve plot 120 milionë dollarë në vit nga xhepat e tyre. Mjafaton 1/10 e kësaj shumë për të mbuluar të gjitha nevojat për shpenzime të mirëmbajtjes, pa vendosur tarifa shtesë. Vetëm nga kalimi pa pagesë në 'Rrugën e Kombit' Shqipëria ka përfituar direkt dhe indirekt rreth 300-400 milionë euro në vit. Do të mjaftonte një fraksion i këtyre të ardhurave për të përballuar nevojat për mirëmbajtje të të gjithë rrjetit rrugor shqiptar", nënvizoi kreu i PD-së, sipas tij, "Qytetarët e Kosovës do ta ndiejnë të parët këtë akt

Taksa për Rrugën e Kombit, Basha: Do ta shfuqizojmë sa të vijmë në pushtet

"Është edhe barrierë shtesë mes Shqipërisë dhe Kosovës"



Kryetari i PD-së,
Lulzim Basha

Rruga e Kombit

Kompania koncesionare: Kontrata u firmos nga LSI

Petrit Vasili: Refuzojeni këtë taksë të pisët, ta paguajë qeveria

Lëvizja Socialiste për Integrim, u kërkoi dje, qytetarëve ta refuzojnë pagesën e taksës në rrugën e Kombit, në shenjë proteste ndaj këtij vendimi të qeverisë. "Refuzojeni ta paguani taksën për rrugën e Kombit, le ta paguajë vetë qeveria", tha dje, në një status në rrjetin social, "FB", Petrit Vasili. "Koncesionin e 'Rrugës së Kombit' e ka miratuar qeveria e koncesioneve të pista. Qytetarët nuk kanë taksirat të paguajnë taksë për të kaluar në një rrugë ku e kanë dhënë boll kontribut me taksat e tyre për ndërtimin e saj", tha dje, kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili. "Qeveria ta paguajë vetë këtë taksë, se qytetarët e kanë përmbushur tashmë, me të tepërt bile detyrimin e tyre", shtoi ai. Sipas Vasilit, "qeveria ka dhënë qindra milionë euro koncesione në



shëndetësi e gjithandej, le t'i anulojë ato dhe le të financojë mirëmbajtjen e rrugës së kombit. Qytetarët që udhetojnë drejt verilindjes kryesisht vëllezërit nga Kosova janë të dënuar të paguajnë për të ardhur në Shqipëri, sepse qeveria e kryeministrit vjedh. Refuzojeni ta paguani këtë taksë të pisët, jeni në të drejtën tuaj". Por, pas kësaj deklarate, ka reaguuar edhe kompania koncesionare "AHC". Në përgjigjen e saj, kompania thekson se ka qenë

pikërisht Ministri i LSI, Sokol Dervishaj që negocioi kontratën e koncesionit. Sipas deklaratës, në 14 tetor 2016, ministri i Transportit i kohës Sokol Dervishaj, drejtoi negociimin e kontratës dhe pasi negocioi tarifën e kalimit të mjeteve, firmosi kontratën. Sipas kompanisë koncesionare AHC, kontrata e firmosur nga Sokol Dervishaj kaloi në qeveri ku ai mbrojti këtë koncesion dhe të njëjtin qëndrim por saj, mbajti edhe në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit. Kompania vë në dukje se pro tarifës u shprehën publikisht edhe zyrtarë të tjerë të LSI. Deklarata e kompanisë koncesionare AHC, citon edhe deklaratat e ish-ministrit të Transporteve Sokol Dervishaj ku në 14 tetorin e vitit 2016 ai thekson ndër të tjera se "është e rëndësishme që ky koncesion të fillojë të operojë sa më parë".

SALI BERISHA

Ish-kryeministri Sali Berisha, ka reaguuar duke e quajtur skandal vendosjen e tarifës rrugore sidomos për kosovarët, të cilët dërgojnë deri në 300 milionë euro në vit në Shqipëri. Berisha këtë pagesë e quan "taksa 'Edvin'", dhe është shprehur se kryeministri Edi Rama është turpi i kombit.



Bylykbashi: Rama po të mundet, takson edhe mikrobet?

Deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi deklaroi dje, se "Rama po të mundet takson edhe mikrobet". Nisur nga një histori e vjetër, Bylykbashi u shpreh kundër vendosjes së taksës në rrugën e Kombit. "Në vitin e largët 2002, në një mbledhje ndërministeriale të drejtuar nga Majko Kryeministër, ku asistojë si vëzhgues i OSBE, Edi Rama kërkonte me shumë fonde për të si kryebashkiak, dhe thoshte se ishte e kotë të shpenzoheshin për të vobektët. Një koleg i huaj më tha: "Rama është gati të taksojë çdo gjë që është më e madhe se një mikron, boll që të lëvizë ose të marrë frymë." Kishte të drejtë. Asokohe, Tirana ishte qyteti me taksat më të larta. Sot Shqipëria ka taksat më të larta në rajon. Ndaj kush besoi se taksa progresive është më e mirë se taksa e sheshtë nuk ka pse vajton sot taksën e 'Rrugës së Kombit'. Me të sheshtën u ndërtua nga Berisha, me progresiven po taksohet dyfish nga Rama",- e mbylli historinë Bylykbashi.

primitiv të urrejtjes nga banda në pushtet në Shqipëri. Kjo tarifë është një barrierë dhe kosto e shtuar për ta". Duke e cilësuar "akt kriminal", Basha u shpreh se kjo dëmton edhe ekonominë e Shqipërisë, duke rritur

koston për shërbimet dhe produktet dhe duke goditur qytetarët dhe bizneset, nga Kukësi e Mirdita në Lezhë, Shkodër, Kurbin, Krujë, Tiranë dhe në Portin e Durrësit. Turizmi po kështu do të pësojë një goditje të rëndë.

"Por më së shumti atë do ta ndiejnë banorët e varfër të zonave rreth 'Rrugës së Kombit', të cilët edhe aktualisht e kanë tejet të vështirë të përballojnë tarifën e furgonëve e autobusëve. Rama premtoi se do ta zgjidhë çështjen e rezidentëve të kësaj zone, por deri tani asnjë masë nuk është marrë", tha Basha. "Partia Demokratike i qëndron premtimit të saj për të shfuqizuar që ditën e parë në pushtet taksën e qarkullimit si dhe për të hetuar me transparencë çdo koncesion të dhënë nga klani kriminal në krye të Shqipërisë, duke u zotuar se çdo koncesion që cenon interesat e shqiptarëve do të shfuqizohet dhe përgjegjësit do të vihen përpara drejtë-



TARIFAT NGA JAVA E ARDHSHME PËR TË KALUAR NË RRUGËN E KOMBIT

- Klasa 1 motor - 2.5 euro
- Klasa 2 veturë - 5 euro
- Klasa 3 autobus & kamionçinë - 11.2 euro
- Klasa 4 kamion i mesëm - 16.2 euro
- Klasa 5 kamion i rëndë - 22.5 euro



Taksa në Rrugën e Kombit, qeveria e Kosovës shpreh pakënaqësi

Pal Lekaj: S'na informuan, do bëjmë kërkesë për zbritje

Kosova ka shprehur pakënaqësinë dhe mo saprovimin ndaj taksës së vendosur nga qeveria shqiptare në Rrugën e Kombit. Autoritet e Kosovës kanë reaguar publikisht se nuk janë pyetur dhe as informuar për një vendim të tillë. Ministri i Infrastrukturës së Kosovës, Pal Lekaj, ka bërë të ditur për "Telegrafin" se është i interesuar që sa më parë të definojnë gjërat sa u përket autostradave, duke thënë se do të merrren parasysh modelat me të mira për zhvillimin e këtij projekti. Sipas tij, duhet të shikohet mundësia e koncesionimit të taksës rrugore me kushtin që mirëmbajtja e rrugëve të bëhet nga koncesionuesi. "Sa i përket tarifës së pagesës për shfrytëzimin e autostradave, presim një raport matjeje për numrin e automjeteve që qarkullojnë dhe për kushtet tjera që duhet të plotësohen për të arritur një çmim, i cili do të jetë i arsyeshëm për qytetarët. Do të shikohet edhe mundësia e koncesionimit të taksës rrugore, kjo me kushtin që mirëmbajtja e rrugëve të bëhet nga koncesionuesi. Ne jemi të interesuar që sa ma parë t'i definojmë gjërat sa u përket autostradave, edhe për pagesat në rrugë, por edhe për funksionalizimin e vendeve të parapara për pushimorë në brezin rrugor", ka thënë Lekaj, duke shtuar se do të merrren parasysh modelat me të mira për zhvillimin e këtij projekti. Ndërsa, Safet Gërxhalii, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), tha se një taksë e tillë për autostradën do të gjenerojë shumë më tepër efekte negative se sa pozitive. Ai sqaroi se ekzistojnë barrierat të mjaftueshme në mes të një populli të ndarë në dy shtete dhe kjo do të jetë një barrierë shtesë që do të godasë më së shumti kosovarët.

Javën e ardhshme pritet aplikimi i tarifave nga 2.5 deri në 22.5 euro

Testohen sportelet në Rrugën e Kombit, ja pagesat për motorët deri te kamionët

Gjikhuri: Koncesionari do ta mirëmbajë autostradën

Përcjellës së djeshme çdo automjet që do të kalojë nga Rruga e Kombit do të paguajë një taksë që varion nga 2.5 euro për motorët deri në 22.5 euro për kamionët e rëndë. Dje në mesditë u testuan sportelet, të cilët do të shërbejnë për pagesën e taksës së Rrugës së Kombit. Janë bërë gati 4 sportele, nga dy për çdo kah të lëvizjes, të cilat koncesionari ka nisur t'i testojë nga ana teknike. Kjo do të vazhdojë deri javën e ardhshme, e rreth mesit të prillit pritet të nisë edhe pagesa. Një vendim i tillë ka sjellë mjaft reagime, veçanërisht të banorëve të zonës apo të shoferëve të furgonëve apo autobusëve, që e bëjnë çdo ditë atë rrugë. Nga ana e saj, Ministria e Infrastrukturës ka sqaruar opinionin lidhur me vendosjen e tarifës për të kaluar në Rrugën e Kombit. Në një deklaratë për mediat, Ministria e Infrastrukturës shpjegon se për çfarë do të shërbejë kjo taksë dhe si do të funksionojë. "Në marrëveshjen e koncesionit, datë 6.12.2016 'Për ndërtim, përmirësim, shfrytëzim, mirëmbajtje të autostradës Milot-Morinë', miratuar me VKM nr:870, datë 14.12.2016 'Për miratimin e kontratës së koncesionit, 'Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot-Morinë', ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Konsoriumit "Catalyst Viva Das General Contracting, LLC-Salillari shpk - Bee Tech-Violipaj Ateve - Kastrati sh.a., ndër të tjera parashikohet se: koncesionari përdor një shesh me dy kahe për pagimin e taksës në afërsi të tunelit të Thirrës dhe koncesionari mbledh dhe mban të ardhurat nga taksat e rrugës. Objektivi kryesor i këtij projekti koncesion/PPP i punimeve dhe shërbimeve është përmirësimi i autostradës dhe shfrytëzimi dhe mirëmbajtja efikase e saj. Koncesionari do të përmirësojë, operojë dhe mirëmbajë autostradën sipas një pakete të paracaktuar të standardeve të performancës për një periudhë 30-vjeçare të koncesionit. Taksa e rrugës karakterizohet dhe taksatohet sipas përlllogaritjes së klauzulës së kontratës së



Sportelet në Rrugën e Kombit

koncesionit, në varësi të klasës së automjetit në bazë të klasifikimit të automjeteve", thuhet në deklaratën e ministrisë. Tarifat e miratuara janë motor 2.5 euro, veturë e vogla 5 euro, autobusë dhe kamionçina 11.2 euro, kamion i mesëm 16.2 euro dhe kamion i rëndë 22.5 euro.

KONTRATA

Koncesionari i përbërë nga një kompani turke dhe 2 shqiptare është në vitin e dytë të kontratës, ku pritet fillimi i tarifimit. Sipas kontratës, përveç traut të pagesave, koncesionari duhet të kryente disa investime në dy vitet e para. "Top Channel" ka siguruar kostot e këtyre punimeve, të cilat nuk janë botuar në Fletoren Zyrtare.

Sipas të dhënave, investimi për 2 vitet e para shkon rreth 18 milionë euro. Por kur kanë mbetur më pak se 9 muaj nga afati final për kryerjen e investimeve, koncesionari ka përfunduar vetëm sheshin ku drejtuesit e automjeteve paguajnë taksën për çdo kalim në tunel. Ura mbi lumin Drin duhet të rehabilitohet në 2 vitet e para, ndërkohë që deri tani nuk është kryer asnjë punim. Aktualisht, koncesionari po investon rreth 936 mijë euro në rrethimin e autostradës, për ta mbrojtur në dy akset e saj nga rrëshqitja e gurëve. Sipas kontratës, koncesionari do të nisë të marrë subvencion nga shteti për trafikun e munguar që në vitin e parë të vendosjes

së pagesës. Qeveria e garanton privatnë që nëse nuk siguron rreth 8 milionë euro vitin e parë, të paguajë diferencën e mbetur. Progresioni vazhdon rritës çdo vit, deri në 14 milionë euro. Përveç subvencionimit, privati do të përfitojë rregullisht taksën e tunelit, për 30 vjet. Sipas studimit të fizibilitetit të IFC, në Rrugën e Kombit kalojnë mesatarisht 5000-6000 automjete në ditë dhe në një përlllogaritje me tarifën minimale 5 euro, koncesionari do të arketojë nga 10 milionë euro vitin e parë, deri në 17 milionë euro vitin e fundit. Kurse zyrtarisht sipas kontratës, në total pas 30 vitesh, koncesionari arketon nga tarifa e kalimit në tunel minimalisht 336 milionë euro.

FOTOLAJM

Tarifa e Rrugës së Kombit prej 5 euro vetëm në një drejtim nuk mund të krahasohet me asnjë vend të rajonit për çmimin e lartë që ka. Në këtë fotolajm po tregojmë faturat se sa paguhet në rrugën nacionale Kapshticë-Selanik, e cila është 231 kilometra autostradë me tri korsi, pa asnjë çarje apo dalje anësore e në total paguhet 5.70 euro. Ndërsa distanca nga Rrësheni në Kalimash është 61 kilometra për të cilat shqiptarët paguajnë 5 euro.

Krahasimi me rrugën nacionale Kapshticë-Selanik

STAVRO	NETIPTA	PRETA
1	24,000	24,000
2	1,200	1,200
3	1,200	1,200
4	1,200	1,200
5	1,200	1,200
6	1,200	1,200
7	1,200	1,200
8	1,200	1,200
9	1,200	1,200
10	1,200	1,200
11	1,200	1,200
12	1,200	1,200
13	1,200	1,200
14	1,200	1,200
15	1,200	1,200
16	1,200	1,200
17	1,200	1,200
18	1,200	1,200
19	1,200	1,200
20	1,200	1,200
21	1,200	1,200
22	1,200	1,200
23	1,200	1,200
24	1,200	1,200
25	1,200	1,200
26	1,200	1,200
27	1,200	1,200
28	1,200	1,200
29	1,200	1,200
30	1,200	1,200

DENONCIMET SHIFRAT

Bilanci 5-mujor i platformës së bashkëqeverisjes, zgjidhen 4454 ankesa

Rama, qytetarëve: Të bëhemi bashkë, ka ende grabitqarë të së shkuarës

Nga Kryeministria janë zgjidhur 852 ankesa, në shqyrtim 235

Darina Tanushi

Rreth 4500 ankesa të qytetarëve janë regjistruar në 5 muaj të platformës së bashkëqeverisjes, "Shqipëria që duam". Këtë fakt e bëri me dije dje kryeministri Rama, duke publikuar raportin 5-mujor të kësaj pune. "Kam kënaqësinë të ndaj me ju bilancin 5-mujor të ndërveprimit tonë përmes platformës së bashkëqeverisjes "www.shqipëriaqeduam.al" dhe ju lutem, merrni 2 minuta nga koha juaj për ta lexuar dhe kuptuar se sa e madhe është fuqia jonë, nëse bëhemi bashkë të zgjidhjen e problemeve "të vogla" të gjithkujt, në zyrat e shtetit, ku ende grabitqarë e parazitë të së shkuarës vazhdojnë të shkelin të drejtat e njerëzve të zakonshëm të këtij vendi", shkroi Rama në rrjetin social "FB". "Apeli ynë për të gjithë, pa dallim bindjesh e përkatësish politike është: regjistrohuni në koalicionin e madh të bashkëqeverisjes përmes platformës "shqipëriaqeduam.al" dhe me një mesazh të drejtë-përdrejtë, çdo ministër vihet në dispozicionin tuaj. Kështu, ju mund të zgjidhni problem tuaj apo përcillni fjalën tuaj deri në qeveri dhe njëkohësisht të ndikoni që qeverisja të bëjë më shumë e më mirë, për Shqipërinë që duam dhe shtet-punëmirëqenie", thuhet në raportin e publikuar nga kryeministri Rama. Gjatë këtij 5-mujori në platformën "shqipëriaqeduam.al" janë zgjidhur në total nga niveli qendror 4454 ankesa, ndërsa janë në proces shqyrtimi 553 ankesa. Më konkretisht, nga Kryeministria janë zgjidhur 852 ankesa, ndërsa në shqyrtim janë 235 të tilla, Ministria e Drejtësisë ka zgjidhur 1326 dhe janë në shqyrtim 120; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka zgjidhur 402 ankesa dhe janë në proces 40; Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturasë ka zgjidhur 418 anke-



Kryeministri Edi Rama

sa dhe ka në shqyrtim 51; Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka zgjidhur 405 dhe ka në proces 42; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka zgjidhur 454 dhe ka në shqyrtim 27; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka zgjidhur 193 dhe ka në proces 4; Ministria e Brendshme ka zgjidhur 214 dhe ka në proces 16; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka zgjidhur 77 dhe ka në proces 9; Ministria e Mbrojtjes ka zgjidhur 48 dhe ka në proces 3 ankesa. Ndërsa Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme ka zgjidhur 36 ankesa dhe ka në proces 4 të tilla, Ministria e Kulturës ka zgjidhur 24 dhe ka në proces 1 dhe Ministria e Diasporës ka zgjidhur 5 ankesa dhe ka në proces 1. Lidhur me zgjidhjen e problemeve në nivel vendor, në total janë zgjidhur 470 ankesa dhe janë në proces zgjidhjeje 160 të tilla. Konkretisht në Tiranë janë zgjidhur 187 dhe janë në proces 57 ankesa, në Vlorë janë zgjidhur 52 dhe 27 janë në proces, në Fier janë

Presidenti

Presidenti Ilir Meta ishte dje i ftuar i Arqipeshvrit të Firences, Kardinal Xhuzepë Betori në ceremoninë e meshtë të së dielës para Pashkëve. "Falënderojva Kardinal Betorin për vlerësimin e veçantë të tij ndaj Kardinalit tonë Ernest Troshani dhe vëmendjen ndaj shqiptarëve", tha dje Meta.



ILIR META



Gjatë një seance parlamentare

Vota e emigrantëve, Majko: Po shqyrtojmë disa modele

Deri vonë emigracioni është parë si një çështje personale në Shqipëri, por përballë shifrave dhe cilësisë së komunitetit jashtë vendit, shoqëria dhe politika kanë filluar të reflektojnë, theksoi ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko, gjatë një takimi me përfaqësues të komunitetit shqiptar në Modena të Italisë, ku ndodhet së bashku me ministrin e Arsimit, Lindita Nikolla. "Ne jemi fokusuar që të gjitha institucionet që kanë të bëjnë me diasporën të kalojnë me ligj të veçantë, pasi duam të garantojmë jetëgjatësinë e tyre, pavarësisht ndërrimit të qeverive", u shpreh ministri, i cili shtoi se institucionet do të jenë në funksion të angazhimit dhe strukturimit të të gjithë rrjetëve të diasporës. Ministri kujtoi mbajtjen e samitit të dytë për diasporën, gjatë të cilit do të flitet për gjërat që duhen bërë. Përfaqësuesit e komunitetit shqiptar i drejtuan pyetje ministrit Majko, lidhur me të drejtën e votës dhe projektet sa i përket arsimit. Duke e cilësuar votën e emigrantëve si një çështje me shumë rëndësi, ministri theksoi se të gjitha palët politike janë shprehur pro këtij projekti. Ai tha se kanë në tryezë disa modele që do të shqyrtohen me shumë kujdes, për shkak të natyrës komplekse të kësaj çështjeje. Ndërkaq, ministria e Arsimit theksoi rëndësinë që për herë të parë po realizohet një regjistër i të dhënave.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
SHOQËRIA PËRMBARIMORE "EXECUTOR'S LITUM" (KNC LIT) sh.p.k

Shoqëria Përmbarimore "Executors Litum" sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë për pasuritë e paluajshme: Truall me nr. pasurie 45/8, me sip. 4392 m2, ZK 1006, vol 01, fq.197, e ndodhur në Ahmetajq Tiranë në pronësi të Petrit Shqelget Elezi.
Çmimi me të cilin do të fitojë ankandi është në vlerën 119.008 Euro
Nëdërtese me nr. pasurie N/45/8, me sip. 1167 m2, ZK 1006, vol 9, fq.197, e ndodhur në Ahmetajq Tiranë në pronësi të Petrit Shqelget Elezi, Allin Derwish, Ermir Stafu.
Çmimi me të cilin do të fitojë ankandi është në vlerën 208.572 Euro
Ankandi do të zhvillohet në datë 06.04.2018 ora 16.00, në zyrën përmbarimore "Executors Litum" sh.p.k, me adresë Blv "Zhan Darr", Kulla 1 Toknoprojekt, shk 1, kati 4, ap 10, Tiranë.

FORCIMI I POLICIMIT NË KOMUNITETIN NË SHQIPËRI
Thirrje për projekt-propozime

"Forcimi i Policimit në Komunitetin Shqiptar", program që financohet nga Qeveria Suedeze dhe që asiston zbatimin e reformës së policimit në komunitet në Shqipëri, shpall **Thirrjen Nr.2 Për Aplikime**.

Organizata Joffitimpurisë (OJF), konsorciume dhe Organizata me Bazë Komunitare të cilët dëshirojnë të aplikojnë për grante nën Skemën e Grantëve të Këtij Programi, janë të ftuar të paraqesin projekt-propozime në kuadër të Thirrjes Nr.2, e cila do zbatohet në qarqet Tiranë, Elbasan, Kukës dhe Gjirokastrë. Inkurajohen të aplikojnë organizata me seli në zonat ku parashikohet të zbatohet thirrja dhe projekt-propozimet të përfshijnë jo vetëm Bashkitë Qendër Qarku (Tiranë, Elbasan, Kukës dhe Gjirokastrë) por edhe bashkitë e tjera përberëse (psh. Kavajë, Tropojë, Gramsh etj.), apo njësi administrative të tyre.

Për organizatat të cilat nuk kanë seli në këto zona, si kusht detyrues për aplikim në këtë thirrje, është bashkë-apikimi me një organizatë lokale/aktivistë lokale duke nënshkruar paraprakisht një marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e projektit.

Programi do të ofrojë tre lloj grantesh:

- Grante deri në 5,000 € (3 për qarkun Elbasan, 1 për qarkun Kukës) dhe grante deri në 10,000 € (4 për qarkun Tiranë) do të jepen për projekt-propozime që synojnë a) fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile për të mbështetur krijimin dhe ngritjen e kapaciteteve të koalicioneve me bazë komunitare me synim përmirësimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit e vazhdueshëm mes Policisë së Shtetit dhe komuniteteve vendore si dhe ngritjen e besimit të ndërsjellë dhe; b) Përmirësimin e ndërveprimit mes Policisë së Shtetit dhe aktorëve të tjerë lokalë, anëtarë të mekanizmeve lokale të referimit, për ngritjen e cilësisë së masave parandaluese dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Atati kohor për zbatimin e projektit: deri në 18 muaj
- Grante deri në 5,000 € (nga 2 grante për qarqet Elbasan, Kukës dhe Gjirokastrë dhe 3 për qarkun Tiranë) do të jepen për projekt-propozime që synojnë krijimin dhe konsolidimin e partneriteteve ndërmjet policisë, institucioneve vendore dhe komuniteteve duke pasur në fokus rininë, si iniciativë në fushën e zgjidhjes së konflikteve, ndërgjegjësimin, pasojat e përdorimit të drogave dhe substancave narkotike, sigurinë në trafikun rrugor, bujqësinë dhe krimin kibernetik, trafikimin e qenieve njëzore, krimet homologjike, ekstremizmin e dhunshëm, etj; me theks të veçantë në masat parandaluese. Atati kohor: deri në 7 muaj

Projekt-propozimet duhet të plotësohen sipas Formularit të Aplikimit dhe Udhëzuesit për Aplikime. Të dy këto dokumente mund të konsultohen / shkarkohen nga linku <http://www.cp-project/alkema-e-granteve/>. Aplikimi dhe dokumenti mbeshtetës duhen dorëzuar deri në datën 22 Prill 2018, ora 17.00. Për më shumë detaje referohuni në: <http://www.cp-project.al/>



Zbardhet pasuria e një prej deputetëve që është vënë së fundmi nën akuzë nga Partia Demokratike, Alket Hyseni. I angazhuar në disa detyra shtetërore të rëndësishme, pjesë e profesionistëve që i bashkohen pushtetit, deputet i ri në legjislaturën e fundit, Hyseni ka një pasuri të konsiderueshme, sipas vetëdeklarimit të depozituar në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit, Kontrollit të Pasurisë dhe të publikuar nga "Open Data". Sipas deklarimit të tij, ai zotëron disa apartamente dhe mijëra metra katrorë sipërfaqe toke. Ndër vite, ai ka mbajtur një sërë funksionesh. Kështu, nga viti 2003 deri 2005 ka qenë në doganën e Kakavijës, në 2016 drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Parandalimit dhe Pastrimit të Parave. Në 2017 ndihmës në Kryeministri dhe nga qershori 2017 deputet. Ai është pronar me 100% i dy apartamenteve banimi me sipërfaqe 120 m2 secili, porositur më dt. 10.09.2008, blerë me të ardhura nga emigracioni, puna, biznesi e kursime familjare, vlera 93 600 euro (46 800 euro secili). Po ashtu, ka një tjetër banesë me sipërfaqe 120.3 m2, porositur më dt. 31.05.2010, burimi me të ardhura nga puna, biznesi dhe sipas akt-marrëveshjes së shkëmbimit, vlera 4 691 700 lekë. Një tjetër apartament 120.3 m2, me vlerë 4 691 700 lekë si dhe tre garazhe me 30 m2 secili dhe i një garazhi me sipërfaqe 50 m2. Ai zotëron disa metra katrorë troje dhe tokë arë, të cilat ia ka blerë sipas atyre që deklarohen nga puna në emigracion dhe burimet e familjes. Pak ditë më parë, ai reagoi pas akuzave të bëra nga opozita se i ka vjedhur 11 mijë metra katrorë tokë në Dhërmri familjes Bua. Në një postim të gjatë në 'FB', ai tha: "Toka bujqësore është fituar nga një AMPT (tapl) në emër të kumatit të zonjës që akuzon, e marrë para dhjetëra vitesh dhe e regjistruar me vendim gjykatë. Është transferuar me kontratë noteriale para disa viteve tek një person i tretë, përpara se të kalonte në pronësinë time të përkohshme. Nuk e njoh fare përfituesin fillestar të kësaj prone (kunati i zonjës Bua). Ndërkohë, zonja nuk ka përfutur sipërfaqe toke, pasi nuk ka qenë banore e fshatit Dhërmri në vitin 1991 dhe nuk i takon sipas ligjit". Hyseni shton më tej se zonja Irini Bua dhe bashkëshorti i saj i kanë humbur disa beteja gjyqësore dhe kanë bërë disa kallëzime penale në vitin ndaj shumë personave dhe institucioneve, madje edhe ndaj tij, por që janë pushuar si të papabuzuara sipas tij.

Zbardhet pasuria e deputetit të akuzuar se përvetësoi 11 mijë metra tokë

Deputeti i PS, Alket Hyseni, pronar i njëra metrave troje, 5 shtëpi e 6 garazhe

Në shkurt 2017 bleu 5 mijë metra katrorë arë në Tiranë



Deputeti i PS-së, Alket Hyseni

DEPUTETI
"Nuk e njoh fare përfituesin fillestar të kësaj prone (kunati i zonjës Bua). Ndërkohë zonja nuk ka përfutur sipërfaqe toke pasi nuk ka qenë banore e fshatit Dhërmri në vitin 1991, dhe nuk i takon sipas ligjit".

Grabitja e bregdetit, PD: Hyseni bleu tokën e tjetërsuar

Partia Demokratike, nëpërmjet deputetit Enkelejd Alibeaj publikoi disa dokumente, të cilat siç tha ai provojnë se kryeministri Edi Rama është pjesë e skemës për grabitjen e tokave në bregdet. Dokumentet sipas Partisë Demokratike lidhen me deputetin social-ist, Alket Hyseni, që përvetësoi sipas PD-së 11 mijë metra katrorë tokë në bregdet. "Edi Rama me firmën e tij ka vendosur dy herë rresht që në tokat në bregdet të familjes Bua, në Dhërmri, të ndërtohet resort turistik, duke mos marrë parasysh vendimin e gjykatës për pezullimin e çdo veprimi me pronën. Është e qartë se skema mafioze e grabitjes së tokave në bregdet ka në krye Edi Ramën dhe për bashkëpunëtor deputetin e tij Alket Hyseni", tha Alibeaj. Ky rast sipas deputetit Alibeaj, është ideal që drejtësia të vërtetë se nuk është e kapur politikisht dhe punon për qytetarët e jo për pushtetarët. "Partia Demokratike ka në dorë dokumente që provojnë se Edi Rama është pjesë e skemës për grabitjen e tokave në bregdet, në rastin konkret të grabitjes së pronës së familjes Bua në Dhërmri", tha Alibeaj. Sipas tij, "peshk më të madh se kaq drejtësia nuk ka ku të gjejë dhe është rasti ideal për t'u dhënë shqiptarëve shpresën reale për një drejtësi jopolitike, që punon për qytetarët dhe jo për pushtetarët".

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

ALKET HYSENI	
Inspektor - Dogana Kakavijë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	2003
Koha e marrjes së detyrës/mandatit	2003
Koha e lënies së detyrës/mandatit	2005
Drejtor i Përgjithshëm i DPPP - Drejtoria e parandalimit dhe Pastrimit të Parave	2016
Koha e marrjes së detyrës/mandatit	2016
Koha e lënies së detyrës/mandatit	2017
Këshilltar - Kryeministri	2017
Koha e marrjes së detyrës/mandatit	2017
Deputet Legjislatura IX - Kuvendi i Shqipërisë	07.09.2017
Koha e marrjes së detyrës/mandatit	07.09.2017

PASURI TË PALLUJËSHME
1) Kontratë sipërmarrje me shoqërinë 'S&D INVEST' sh.a për pasurinë e llogjit arë me sip. 5000 m2, në Tiranë, pjesa takuese 50%.
2) Kontratë sipërmarrje për një tokë bujqësore me sip. 5000 m2 dhe 6000 m2. Likuiditete (depozita, kesh, llogari rrjedhëse, debi-kredit, karta krediti/debiti).

1) Gjendja e llogarisë bankare më 26.05.2017 në një bankë të nivelit të dytë, pakësuar 2 825 570.57 lekë.
2) Gjendja e llogarisë bankare në një bankë të nivelit të dytë më 26.05.2017 të ardhura më 28.10.2016 nga shitja e apartamentit, 125 718 lekë. (Në deklaraten e fillimit të detyrës gjendja në këtë llogari ka qenë 105 203 euro).
Të ardhura si drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Ndihmës i Kryeministrit, 525 651 lekë. Deri në datën 12.05.2017

PASURIA E DEKLARIMIT FILLESTAR 2016

Kategorië Përkrahimi dhe burimi
Pasuri të përluajtshme
1) Pronar me 100% i dy apartamenteve banimi me sipërfaqe 120 m2 secili, porositur më dt. 10.09.2008, blerë me të ardhura nga emigracioni, puna, biznesi e kursime familjare, vlera 93 600 euro (46 800 euro secili).
2) Pronar me 100% i një apartamenti banimi me sipërfaqe 120.3 m2, porositur më dt. 31.05.2010, burimi me të ardhura nga puna, biznesi dhe sipas akt-marrëveshjes së shkëmbimit, vlera 4 691 700 lekë.
3) Pronar i tre garazheve me sipërfaqe 30 m2 secili dhe i një garazhi me sipërfaqe 50 m2, burimi të ardhura nga emigracioni, puna, biznesi e kursime familjare dhe sipas akt-marrëveshjes së shkëmbimit, vlera 2 100 000 lekë.
4) Pronar me 22.2% (zotëron 2/9 e truallit) i një trualli me sipërfaqe 1913 m2, blerë me të ardhura nga puna në vitet dhe biznesi, vlera 16 378 216 lekë.
5) Pronar me 100% i një apartamenti banimi me sipërfaqe 225.6 m2, në Tiranë blerë më 31.07.2015 me të ardhura nga puna, biznesi dhe hua marrë shoqërisë "H&A Law Firm" sh.p.k. hua e marrë përmes logarive bankare, vlera 403 050 euro.
6) Garazh me sipërfaqe 12.5 m2, në Tiranë, i blerë më 13.05.2016 vlera 18 700 euro, me të ardhura nga puna, biznesi dhe hua marrë shoqërisë "H&A Law Firm" sh.p.k. hua e marrë përmes logarive bankare.
7) Garazh me sipërfaqe 12.5 m2, në Tiranë, i blerë më 13.05.2016 vlera 18 700 euro, me të ardhura nga puna, biznesi dhe hua marrë shoqërisë "H&A Law Firm" sh.p.k. hua e marrë përmes logarive bankare.
8) Pronar me 100% i një trualli me sipërfaqe 584.81 m2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 284 m2, vlera totale 190 000 euro, nga të cilat, burimi i krijimit 155 000 euro të ardhura nga shitja e tokës bujqësore, përfutur nga ish-bashkëshortja sipas ligjit nr. 7501, shitja është bërë me kontratë ku deklaruesi ka përfutur 155 000 euro. Pjesa tjetër kursime familjare.
9) Zotëron 25% të një toke arë me sipërfaqe 3000 m2, përfutur nga ligji nr. 7501.
10) Zotëron 25% të një toke arë me sipërfaqe 1400 m2, përfutur nga ligji nr. 7501.
11) Zotëron 25% të një toke arë me sipërfaqe 1400 m2, përfutur nga ligji nr. 7501.
12) Pronar me 25% të një toke arë me sipërfaqe 500 m2, përfutur nga ligji nr. 7501.
Likuiditete (depozita, kesh, llogari rrjedhëse, debi-kredit, karta krediti/debiti).

1) Gjendja e llogarisë bankare më 01.07.2016, në një bankë të nivelit të dytë, 88 262 lekë.
2) Gjendja e llogarisë bankare më 01.07.2016, në një bankë të nivelit të dytë, është 105 203 euro. Burimi, të ardhura nga kthim huaje, shitje pasurie dhe të ardhura nga biznesi.
3) Gjendja e llogarisë bankare më 01.07.2016, në një bankë të nivelit të dytë, të ardhura nga paga, dieta, hua dhe shpërbime nga shoqëria "H&A Law Firm" sh.p.k. vlera gjendje 4 296 953 lekë.
4) Gjendje para kesh, të ardhura nga puna e biznesi, 10 000 euro.
5) Hua dhënë një personi të tretë më dt. 07.03.2013, në shumën 21 500 000 lekë, të ardhura të krijuara nga puna në vitet, biznesi dhe shitja e librave. Huaja është dhënë përmes sistemit bankar.
6) Hua dhënë në maj 2010 një personi të tretë, në shumën 67 000 euro. Të ardhurat janë krijuar nga puna ndër vite dhe biznesi. Hua huaja deri në momentin e deklarimit janë rikthyer 44 010 euro.
7) Detyrim për t'u shlyer ndaj shoqërisë "H&A Law Firm" sh.p.k në datën e raportimit qershor 2016 është 10 430 000 lekë. Kjo hua është marrë në bazë të kontratës së huasë të datës 05.03.2015, dhe vlera e parashkuar në kontratë është 200 000 euro, (konvertuar në rreth 27 616 000 lekë). Qëllimi i huas blerjen e një apartamenti. Është marrë hua vetëm në vlerën 15 430 000 lekë. Janë shlyer 5 000 000 lekë pasi është shitur një automjet. Sipas kontratës huaja është pa interes dhe me afat shlyerje jo më vonë se data 31.2020).

Të tjera

1) Të ardhura nga paga dhe shpërbime (janar - 28.06.2016.) si drejtor (ekspert ligjor) i shoqërisë "H&A Law Firm", 3 809 412 lekë.
2) Të ardhura (janar - 28.06.2016.) si kryetar i Këshillit Mbikëqyrës, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1, 182 484 lekë.
3) Të ardhura (janar-28.06.2016.) si kryetar i Këshillit Mbikëqyrës Ujësjellës Kanalizime, Fushë-Krujë, 73 223 lekë.
TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET NË VEPRIMTARI PUBLIKE/PRIVATE 2016
Të ardhura nga paga dhe shpërbimet
1) Të ardhura nga paga dhe shpërbime (janar-28.06.2016.) si drejtor (ekspert ligjor) i shoqërisë "H&A Law Firm", 3 809 412 lekë.
2) Të ardhura si drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, 687 502 lekë.
Të ardhura nga bonuset nuk ka.
Të ardhura si këshilltar/anëtarë bordesh.
1) Të ardhura (janar - 28.06.2016.) si kryetar i Këshillit Mbikëqyrës, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1, 182 484 lekë.
2) Të ardhura (janar-28.06.2016.) si kryetar i Këshillit Mbikëqyrës Ujësjellës Kanalizime, Fushë-Krujë, 73 223 lekë.
3) Të ardhura si kryetar i Këshillit Mbikëqyrës Ujësjellës Kanalizime, Fushë-Krujë, 10 837 lekë.
4) Të ardhura si kryetar i Këshillit Mbikëqyrës, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1, 80 862 lekë.
Të ardhura nga detyrime të shlyera nga të tretë
1) Të ardhura nga shitja më 27.10.2016 i një ap. banimi me sip. 120 m2 në Tiranë, vlera 39 800 euro.
Të ardhura vjetore si % ndaj të ardhurave të pagës nga ky funksion.
Të tjera
1) Deklaron si shtesë pasurie dy "toka bujqësore" 5000m2 dhe 6000 m2, fituar me kontratë shkëmbimi. Shikëmbimi është bërë me dy apartamente dhe tri garazhe të deklaruar më herët. (Nuk jetep vendndodhja e tokave bujqësore dhe data e veprimeve ligjore).
2) Gjendja e llogarisë bankare në një bankë të nivelit të dytë në 31.12.2016, pakësuar 3 427 279 lekë.
3) Gjendja e llogarisë bankare në një bankë të nivelit të dytë në 31.12.2016, të ardhura nga shitja më 28.10.2016 i apartamentit 140 718 euro. (Në deklaraten e fillimit të detyrës gjendja në llogari ishte 105 203 euro nga të cilat më 27.09.2016 janë transferuar 5 000 euro në llogarinë e kartës së kreditit dhe më 28.10.2016 janë kredituar 39 800 euro nga shitja e apartamentit).
4) Kartë krediti me limit 200 000 lekë.
5) Kartë krediti me limit 1 700 euro.
SHPENZIMET E DEKLARUESHME 2016
Shpenzime për blerjen e një arë me sip. 5000 m2 në Tiranë, marrë më 08.02.2017 me të ardhura nga shitja e ap. vlera 8 000 euro, pjesa takuese e deklaruesit për këtë pronë sipërfaqe arë është 50%.

PERMBYTJET SITUATA NE SHKODER



Përmbytjet në Shkodër



Raportimet zyrtare, 4500 hektarë dhe qindra banesa nën ujë. Banorët apelojnë për ndihmë

"Duam autonomi si Katalonja, e menaxhojmë vetë situatën"

Administratori i Njësisë Ana e Malit: Kemi resurse mjaftueshëm, të mos lodhim njeri

SHKODER

Pas afro dy javësh, mbi 4555 hektarë rreth qytetit të Shkodrës vijojnë të jenë nën pushtetin e ujit. Dhjetëra banesa ndodhen të rrethuara nga uji, ndërsa banorët bëjnë apel për ndihmë. Në këto kushte, Arben Ceni, administrator i njësisë Ana e Malit është shprehur se në qoftë se askush nuk mund të bëjë diçka për Shkodrën, atëherë të dalin qytetarët dhe ta menaxhojnë vetë vendin. "Shkodra me këto resurse që ka mund të marrë edhe autonominë, kështu do shkojë puna. 3 hidrocentralet janë në Qarkun e Shkodrës, kemi Thethin, kemi plazhin më të mirë në Shqipëri, Velipojën, kemi liqenin më të madh në Shqipëri dhe Ballkan po ta marrim si radhitje. Të gjitha këto janë resurse, domethënë në s'kemi nevojë për të qenë të varur).

Domethënë si Katalonja, të ndahemi edhe ne dhe ta menaxhojmë ne vendin tonë si Shkodër, të paktën të mos ia vëmë fajin kujt. Pse ta vëmë në siklet kryeministrin. Ai të vazhdojë të punojë me Vjosën me Semanin, të mos merret me Drinin e këto". Ndërkohë, sipas Bashkisë së Shkodrës nevojiten ndërhyrje në lartësimin e disa argjinaturave, si dhe furnizimi i banorëve me ujë të pijshëm dhe ushqime. Më të paraqitet situata pas inspektimeve në terren të bëra nga Bashkia Shkodër.

NJËSIA ADMINISTRATIVE DAJÇ

Kërkohej të ndërhyhet për lartësimin e argjinaturës së Pentarit, Shiriqit dhe Darragjatit. Rruga Shiriq-Darragjat, rruga Belaj-Rrushkull janë të bllokuara. Në disa shkollë në ambientet e brendshme të shkollës ka prezencë uji.



Efektive të forcave të Armatosura në ndihmë banorëve të Shkodrës

4555

HEKTARË

Mbi 4555 hektarë rreth qytetit të Shkodrës vijojnë të jenë nën pushtetin e ujit. Dhjetëra banesa ndodhen të rrethuara nga uji, ndërsa banorët bëjnë apel për ndihmë. Pas inspektimeve në terren, Bashkia e Shkodrës paraqiti situatën në të gjitha zonat e prekura nga përmbytjet.

Kanë rënë disa shtylla të energjisë elektrike në rrugën e Dajçit. Bashkia kërkon nga OSHEE ndërhyrje emergjente duke marrë masat përkatëse. Paraqitet shumë e nevojshme vendosja e shenjave orientuese në rrugë për të bërë të mundur

kalimin.

Janë mbi 250 shtëpi të rrethuara nga uji. Gjithashtu, kërkohet furnizim me ujë të pijshëm për banorët në mënyrë të vazhdueshme.

NJËSIA ADMINISTRATIVE ANA E MALIT

Ujësullësi Oblika 1 dhe Oblika 2 janë jashtë funksionit. Nevojiten çizme të gjata për banorët. Janë 177 shtëpi të rrethuara nga uji, 150 në Obot dhe 27 në Goricë. Bashkia Shkodër ka bërë të mundur furnizimin e banorëve me ujë të pijshëm dhe me pako ushqimore.

NJËSIA ADMINISTRATIVE BËRDICË

Në Njësinë Administrative Bërdicë janë mbi 1000 ha tokë e përmbytura. Stacioni i pompave të Ujësullësit në Trush si pasojë e përmbytjeve është jashtë funksionit. Janë 50 shtëpi të rrethuara nga uji. Nevojiten furnizimi me ujë të pijshëm për banorët.


NJËSIA ADMINISTRATIVE VELIPOJË

Në Njësinë Administrative

"Niveli i ujit ka rënë me 20 cm krahasuar me një ditë më parë"

Xhaçka: Situata drejt përmirësimit, vijon shpërndarja e ndihmave

Zëvendëskryeministrja Senida Mesi dhe ministrja e mbrojtjes, Olta Xhaçka inspekuan ditën e djeshme situatën nga përmbytjet në Dajç e Belaj të Shkodrës. Xhaçka gjatë vizitës theksoi se situata është drejt përmirësimit dhe niveli i ujit ka rënë me 20 cm krahasuar me djeshmën. Sakaq, zëvendëskryeministrja Senida Mesi tha se qeveria qendrore vazhdon gatishmërinë maksimale për t'u ardhur në ndihmë banorëve të prekur nga përmbytjet në Shkodër. "Koordinimi mes të gjithë instancave dhe transparencës nga ana e njëjës vërejtore është tepër i rëndësishëm. Fatmirësisht është rritur sensibilizimi edhe



nga komuniteti i biznesit dhe shoqatave", theksoi Mesi. Ajo u shpreh se "nuk duhet të limtohem vetëm me menaxhimin e situatës të rënduara, por edhe në zgjidhje afatgjatë pas kalimit të situatës". Ministrja Xhaçka tha se fokusi i ditës është ofrimi i ndihmave për çdo banor në vështirësi, ndërsa menjëherë

pas largimit të ujit, do të nisë vlerësimi i dëmeve. "Zgjidhja afatgjatë për situatën do të përcaktojë edhe penaltitete për bashkitë që nuk marrin masa parandaluese për situatën të tilla", tha ajo. Ndërkohë, ministrja e Mbrojtjes bën të ditur sot se deri tani janë angazhuar 148 forca, 27 mjete, 6 motobarka dhe 2 pompa thithëse dhe po veprojnë në Obot, Livadë, Dajç, Velipojë, Belaj, Trush, Bushat. "Janë transportuar 87 banorë, janë shpërndarë 1500 kg ushqime, 31500 litra ujë i pijshëm, 400 kg koncentrat, vazhdon largimi i ujit nga banesat dhe objektet e rëndësishme me pompa thithëse", thekson njoftimi i ministrit.

Velipojë janë të përmbytura mbi 400 Ha tokë. Në fshatin Ças paraqiten shume probleme në argjinaturë, ku si pasojë kanë detyruar komunitetin të ndërhyjë në riparimin e saj. Kërkohej ndërhyrje emergjente dhe e specializuar. Rruga nacionale është e kalueshme me mjetet e larta të ushtrisë. Ka mungesë të energjisë elektrike pothuajse në të gjithë njësinë. Janë shfaqur edhe problematika në komunikim në mes banorëve, për shkak të ndërprerjeve të transmetimit në disa kompani telefonike. Paraqitet shumë e nevojshme vendosja e shenjave orientuese në rrugë për

të bërë të mundur kalimin. Bashkia Shkodër ka bërë të mundur ndërhyrjen në argjinaturën e Çasit.

NJËSIA ADMINISTRATIVE RRETHINA

Në Njësinë Administrative Rrethina janë të përmbytura 70 Ha tokë. Në zonën e Livadheve janë 70 shtëpi të rrethuara nga uji. Bashkia Shkodër ka bërë të mundur furnizimin e banorëve me bazën ushqimore për gjënë e gjallë dhe ujë të pijshëm për banorët.

NJËSIA ADMINISTRATIVE GURI I ZI

Në Njësinë Administrative

Gur i Zi vazhdon gërryerja e tokës në fshatin Juban, në afërsi të Malit të Vukatanës. Paraqitet shumë problematika kjo dukuri, pasi mund të rrezikohet argjinatura.

QYTETI SHKODËR
Në zonën e Livadheve janë të përmbytura 130 ha. Në këtë rrugë ndodhen mbi 40 shtëpi me prezencë uji afër oborreve të tyre. Me shumë vështirësi kalohet me makinë ushtrisë, ndërsa në disa zona kalimi bëhet i mundur vetëm me varkë. Bashkia Shkodër ka bërë të mundur furnizimin e banorëve me bazën ushqimore për gjënë e gjallë dhe ujë të pijshëm për banorët.

Zbardhet dëshmia e shefit ekonomik në Drejtorinë e Kufirit

Shkodër, hidhet në erë me tritol "Benz"-i, Admir Lishi: Nuk kam konflikt me askënd

SHKODER. Një shpërthim me lëndë plasëse ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në Shkodër. Rreth orës 5:00 një sasi tritolu u vendos në mjetin e shtetasit Admir Lishi. Lënda plasëse shpërtheu në pjesën e prapme të mjetit tip 'Benz' me targë AA 655 MK. Mënjherë pas kësaj ngjarje detaje të reja janë mësuar rreth sasisë së tritolit të vendosur në mjetin që ndodhej i parkuar në lagjen Perash në Shkodër. Burime pranë vendit të ngjarjes bëjnë me dije se lënda plasëse ka shkaktuar vetëm dëme materiale. Në momentin e shpërthimit në makinë nuk ndodhesh askush. Nga sa mësohet Admir Lishi ka një detyrë

NGJARJA

Në momentin e shpërthimit në makinë nuk ndodhesh askush. Nga sa mësohet, Admir Lishi ka një detyrë të rëndësishme në policinë vendore të Shkodrës. Ai është shefi ekonomik tek Drejtoria e Kufirit dhe është efektiv mbështetës në prapavijë. Ende nuk janë të qarta arsyet e vendosjes së lëndës plasëse.

të rëndësishme në policinë vendore të Shkodrës. Ai është shefi ekonomik tek Drejtoria e Kufirit dhe është efektiv mbështetës në prapavijë. Ende nuk janë të qarta arsyet e vendosjes së lëndës plasëse. Pista e parë dysho-

het për shkak të detyrës. Mendohet se mund të ketë qenë një sinjal ndaj 40-vjeçarit për shkak se sasia e vendosur e eksplozivit ka qenë aq e vogël sa nuk i ka shkaktuar dëme të mëdha mjetit tip 'Benz'. Megjithatë

nuk përjashtohet edhe ndonjë pistë tjetër. Grupi hetimor ishte në vendngjarje dhe po heton për të zbardhur të plotë atë që ka ndodhur. Sakaq vetëm pak orë pas ngjarjes zbulohet se çfarë ka deklaruar efektiv i policisë së Shkodrës. Mësohet se 40-vjeçari ka mohuar para grupit hetimor se ka pasur probleme apo konflikt me ndokënd. Në deklaratim të para Admir Lishi është shprehur se nuk e ka idenë se nga ka ardhur shpërthimi me lëndë plasëse në mje-



ti e tij. "Unë nuk e di se si ka ndodhur apo përse ka ndodhur. Nuk kam asnjë problem apo asnjë konflikt me askënd. Nuk e kam idenë nga ka ardhur kjo ngjarje apo se kush fshihet pas saj", ka deklaruar Admir Lishi. Policia pistë kryesore të

momentit ka atë për shkak të detyrës. Megjithatë ende vazhdojnë hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes. Policia po punon për identifikimin dhe kapjen e autorëve. Deri më tani ende nuk ka një ide se kush mund të jenë autorët.

Vrasja e Kreshnik Beqiraj në Fier, zbardhen të tjera detaje rreth autorit Albert Zekaj

Masakroi shokun me çekiç, shoqata fetare: Strehuam vrasësin, nuk e dinim për krimin

FIER

Pak javë pas zbardhjes së krimi makabër në Fier, ku u vra me çekiç Kreshnik Beqiraj, zbardhet dëshmia e misionarëve të një shoqate fetare në Tiranë, të cilën kanë strehuar vrasësin Albert Zekaj, pa e ditur të shkuarën e tij. Misionarët shprehen të tronditur që 32-vjeçari Zekaj, u arrestua si autor i dyshuar i vrasjes makabre në muajin qershor të vitit që shkoi. Ditën që u zhvillua seanca gjyqësore ndaj Zekaj, misionarët tri vajza dhe dy djem, ku vetëm njëra prej tyre ishte shqiptare, udhëtuan drejt Fierit për të mësuar të vërtetën. Më pas misionarët kanë dhënë deklaratim të tyre para grupit hetimor duke theksuar se nuk dyshuan asnjëherë që Zekaj të kishte kryer ndonjë krim. "Jemi tronditur kur e dëgjua lajmin se Alberti mund të kishte vrarë një njeri. Ai erdhi tek shoqata jonë në muajin gusht të vitit të kaluar dhe kërkoj ndihmë. I kemi mundësuar strehim, ushqim dhe veshje sa herë që ka pasur nevojë. Madje i kemi siguruar edhe punë me kohë të pjesshme, kur kemi pasur mundësi. Ai dukej i qetë dhe i dëgjuar. Ishte fjalë-pakë, por kurrë nuk kemi pasur ndonjë dyshim se ai mund të ishte person problematik, e aq më tepër një vrasës. Ai na kishte thënë se kishte pak komunikim me familjen e tij dhe shfaqej si nevojtar, prandaj e kemi ndihmuar. Asnjëherë, askush prej nesh, nuk ka pasur dyshim që ai të kishte kryer një krim. Jemi vërtetë të tronditur që kemi ndihmuar një person të tillë", kanë dëshmuar misionarët. Sakaq, disa ditë më parë, ekspertët e kriminalistikës kanë gjetur gjurmë gjaku në



VËLLAI I VIKTIMËS

"Kam kërkuar prej disa kohësh për vëllain tim dhe kisha dyshime të mëdha. Kam bashkëpunuar me policinë dhe dyshoja tek Albert Zekaj, pasi nuk më pëlqente si tip. E kam takuar personalisht Zekajin dhe kisha debatuar me vëllain se pse jetonte me atë në shtëpi. Shpenzimet e shtëpisë i hiqte vëllai im. Vëllai i kishte kërkuar që të largohej nga shtëpia dhe prandaj janë zënë. Autori duhet të thotë të vërtetën se pse e ka kryer krimin" - është shprehur vëllai i viktimës, Donjet Beqiraj.

banesën ku Kreshnik Beqiraj dhe Albert Zekaj jetonin me qira në periudhën kur u zhduk i ndjeri, duke plotësuar kështu provat ndaj 32-vjeçarit nga Kopliku i Shkodrës. Në 10 mars gjykata ka dhënë masën "Arrest me burg" pa afat për Albert Zekaj i cili, vrau dhe hodhi trupin e shokut të tij Kreshnik Beqiraj në një kanal në fshatin Daullas në

Fier. "Jam i penduar dhe i kërkoj falje familjarëve. Ligji të veprojë. E vrava me çekiç në kokë, i copëtova trupin dhe copat i futa në valixhe", janë fjalët që ka thënë Zekaj pas marrjes së dënimit.

VRASJA

Më datë 22.06.2017 rreth orës 23:00, Albert Zekaj, 32 vjeç dyshohet se e ka vrarë në sende të forta shokun e

dhomës Kreshnik Beqiraj, me të cilin jetonte më qira në qytetin e Fierit. Pas vrasjes mësohet se trupin e viktimës e ka hedhur në afërsi të fshatit Daullas. Ky shtetas ka qenë shok me viktimën Kreshnik Beqiraj, ku janë njohur para tre vjetësh në Belgjikë. Ne vijim të hetimeve dhe informacioneve operative u arrit të identifikohet autori dhe u shoqërua në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier. Pas marrjes në pyetje ai pranoi autorësinë e vrasjes dhe hedhjen e kufomës në vendin ku u gjet. Viktima ishte denoncuar në polici i humbur nga familjarët, por nga veprimet e kryera si dhe nga dyshimet e familjarëve, në muajin Janar 2018 Drejtoria Vendore e Policisë Fier ka nisur hetimet pasi dyshohej se ky shtetas mund të ishte vrarë ose rrëmbyer.

SHKURTE

Në kërkim për tentative vrasje, arrestohet vlonjati

VLORE.Një 33-vjeçar i shpallur në kërkim për vrasje të mbetur në tentative në prill të vitit të kaluar, është arrestuar ditën e djeshme nga policia e Vlorës. Strukturat Policore të Sektorit për Hetimin e Krimeve të Rënda në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, në vijim të punës për kapjen dhe ndalimin e shtetasve të shpallur në kërkim, kanë bërë të mundur ekzekutimin e Urdhrit të Ndalimit ndaj një shtetasi të shpallur në kërkim në fushën e Krimeve ndaj Personit. Në pranga ka rënë Genti Bana, 33 vjeç, banues në Vlorë. Për Genti Banën Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, me vendim Nr.117, datë 26.04.2017, ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg", për veprën penale "Vrasje me dashje, e mbetur në tentativë", e parashikuar nga neni 76 e 22 e Kodit Penal. Ngjarje e ndodhur më datë 15.04.2017, në lagjen "Isa Boletini", ku Genti Bana ka tentuar të vrasë me mjete prerëse shtetasin L.M. Materialet hetimore iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për veprime të mëtejshme.

Policia aksion blit në Elbasan, bien në pranga dy persona

ELBASAN. Policia e Elbasanit ka zhvilluar kontrollë në rrugë lokale dhe ambiente, për kapjen e personave të shpallur në kërkim, atyre që mbajnë armë pa leje, apo që shpërndajnë lëndë narkotike. Nga kontrolli është vënë në pranga një 42-vjeçar pasi iu gjet një armë zjarri pa leje. Ndalimi i shtetasit Lulzim Cekani u bë gjatë një aksioni të shërbimeve të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, të mbështetura nga "Shqiponjat" dhe FNSH-ja, në disa lokale të qytetit pas telefonatave të ardhura nga qytetarët. Gjatë kontrollit fizik të ushtruar në ambientet e një lokali, në lagjen "Brigada e XVII Sulmuese", 42-vjeçarit Cekani i është gjetur dhe sekuestruar në cilësimë e provës materiale, një armë zjarri pistoletë me kalibër 9 mm. Po gjatë kontrollëve të ushtruar gjatë mbrëmjes dhe orëve të para të mëngjesit, janë shoqëruar në ambientet e Drejtorisë së Policisë në Elbasan 8 persona. Ndërkohë kontrollët kanë vijuar dhe nga Policia Rrugore për evidentimin dhe ndëshkimin e shkelësve të Kodit Rrugor, ku gjatë testeve për alkool, 10 drejtuesve të mjeteve, që drejtonin mjetin nën efektin e alkoolit, u është tërhequr Leja e Drejtimit. Sakaq, shtetasi Kamber L., 33 vjeç, banues në Elbasan, është arrestuar pasi është konstatuar nga shërbimet e Policisë Rrugore, duke drejtuar mjetin në gjendje të dehur.

Ndërmjetësi ndërkulturor: Jo më procese gjyqësore për fëmijët që kanë probleme me emrat

Projektligji për shqyrtim, lehtësira për emigrantët shqiptarë në Greqi

Fatos Malaj: Me sa vite qëndrimi do të merret nënshtetësia

Voltiza Duro

Pitet që së shpejti, komisionet e parlamentit grek të miratojnë disa ndryshime në ligjin për emigracionin e nënshtetësive, çka do të sjellë një sërë lehtësirash për emigrantët shqiptarë që punojnë e jetojnë në Greqi. Projektligji i ri që tashmë është marrë në shqyrtim nga pala helene, synon që aplikimi për nënshtetësi greke të kryhet në momentin që shtetasi shqiptar të ketë mbi 10 vite qëndrim në Greqi, me çfarëdo lloje leje qëndrimi. Në një intervistë për Gazeta Shqiptare Fatos Malaj, ndërmjetës kulturor pranë Drejtorisë të Emigracionit, njëkohësisht drejtues i organizatës Përkrahje-Arogji, tregon se firmosjen e marrëveshjes bilaterale me Greqinë, në mënyrë që të njihen periudhat kontributive nga të dyja shtetet, e shikon si diçka shumë të vështirë, për shkak të krizës ekonomike që po kalon shteti helene. Më tej Malaj bën me dije se është propozuar që të gjithë individët që kanë mbushur moshën 65 vjeç, të mos kalojnë në nënkomision për të marrë nënshtetësinë greke.

Çfarë u diskutua në konferencën "Diskutim i hapur për çështjet e emigracionit dhe nënshtetësisë në Greqi"?

Takimi ishte një diskutim-panel mbi ndryshimet që priten në ligjin për emigracionin dhe nënshtetësinë, ndryshime që do të prekjin emigrantët shqiptarë që jetojnë në Greqi e do të krijojnë lehtësira për ta. Ky takim ishte shumë frytdhënës pasi u diskutua mbi shumë ndryshime nga të cilat do të përfitojnë shqiptarët. Në këtë konferencë ishin të pranishëm Miltiadhis Klapas, sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Emigracionit; Llabros Baltisiotis, sekretar i posaçëm për nënshtetësinë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Ilias Hronopoulos, drejtor i drejtorisë së shtetasve të huaj dhe emigracionit në Athinë; Dhimitris Siamatras, drejtor i drejtorisë së gjendjes civile në administratën e decentralizuar të Atikës etj.

Cilat janë disa prej lehtësirave që do të kenë emi-



Fatos Malaj, ndërmjetës kulturor pranë Drejtorisë të Emigracionit

PROBLEMI ME EMRAT

"Të gjithë fëmijët që kanë lindur në Greqi e u janë shfaqur probleme me emrat, deri më tani duhet të hapnin një proces gjyqësor për t'i dhënë zgjidhje situatës. Ndërsa tani, pa propozimeve, pritet që kjo të marrë zgjidhje vetëm me një urdhëresë nga kryetari i bashkisë së zonës", - tha ndërmjetësi në Drejtorinë e Emigracionit.

gratët pas miratimit të projektligjit nga parlamenti helen?

Për sa i përket çështjes së nënshtetësisë, brezi i parë që përfshin të gjithë individët që nuk e kanë mbaruar shkollën në Greqi, deri më tani nuk mundej të aplikojnë për nënshtetësi me çfarëdo lloje leje qëndrimi, por kishin të drejtë të aplikojnë vetëm personat që dispononin lejen europiane. Ndërsa tani, mjafton që të kenë vetëm 12 vite të njohura ligjrisht në Greqi e lejen e qëndrimit në mënyrë që të aplikojnë për nënshtetësi. Pas shqyrtimit ne shpresojmë që të arrihet që nënshtetësia të jepet me dy vite më pak qëndrim të ligjshëm në shtetin helene, pra vetëm 10 vjet. Gjithashtu, në projektligjin që kemi dërguar në parlament, përveç pikave të sipërpërmendura, kemi kërkuar që të gjithë individët që kanë mbushur moshën 65 vjeç, të mos kalojnë në nënkomision për të marrë nënshtetësinë.

Po personat që përfundojnë arsimin e lartë në

Greqi, a kanë të drejtë të aplikojnë për nënshtetësi?

Për brezin e dytë, pra për fëmijët shqiptarë, ka një nen në kushtetutën greke që parashikon që të gjithë ata

MARRËVESHJA

"Të dyja palët janë në diskutime, por e shoh të vështirë pasi në momentin që nënshkruhet një marrëveshje e tillë do të kalojë 'blackout' gjithë ana ekonomike e Greqisë, duke qenë se vazhdon të jetë në krizë ekonomike", - theksoi Malaj.

që kanë dhënë provimet e maturës e pasi përfundojnë dhe arsimin e lartë, iu lind e drejta për të aplikuar për nënshtetësi greke. Por vlen të theksoj se kjo vllente vetëm për ata që përfundonin arsimin e lartë në një institucion shtetëror. Ndërsa tani me ndryshimet e propozimit e reja, kërkojmë që të lejohen të aplikojnë për nënshtetësi edhe personat që përfundojnë arsimin në institu-



Gjatë punimeve të konferencës "Diskutim i hapur për çështjet e emigracionit dhe nënshtetësisë në Greqi"

cione të larta private.

A mendoni se do të nënshkruhet marrëveshja bilaterale me Greqinë dhe Shqipërisë, pra të njihen periudhat e kontributive nga të dyja shtetet?

Firmosjen e marrëveshjes bilaterale me Greqinë, në mënyrë që të njihen periudhat kontributive nga të dyja shtetet, unë e shikoj si diçka shumë të vështirë. Të dyja palët janë në diskutime, por e shoh të vështirë pasi në momentin që nënshkruhet një marrëveshje e tillë do të kalojë "blackout" gjithë ana ekonomike e Greqisë, duke qenë se vazhdon të jetë në krizë ekonomike.

Aktualisht, cilat janë

mbi 65 vjeç (ata që kanë kryer punë me vështirësi) apo mbi 67 vjeç (punët normale). Pensionin e përfitojnë si emigrantët që vazhdojnë të jetojnë në Greqi, si ata që riatdhesohen në Shqipëri.

A do të ketë ndonjë lehtësim për sa i përket vërtetimit të shumta që duhet të dorëzojnë emigrantët shqiptarë për lejet e qëndrimit?

Të gjithë ata që qëndrojnë në Greqi për arsye të veçanta, e që deklarohen që kanë 7 vite qëndrim në këtë shtet, deri më tani duhet të dorëzojnë çdo vit vërtetime. Tani me projektligjin e propozuar, pritet të ndryshojë dhe mjafton vetëm që të vërtetohet që jeton në Greqi, pa pasur nevojë të paraqesë një sërë vërtetimesh.

Si do të veprojë me fëmijët shqiptarë të lindur në Greqi, që u janë shfaqur probleme me emrat?

Të gjithë fëmijët që kanë lindur në Greqi e u janë shfaqur probleme me emrat, deri më tani duhet të hapnin një proces gjyqësor për t'i dhënë zgjidhje situatës. Ndërsa tani, pa propozimeve, pritet që kjo të marrë zgjidhje vetëm me një urdhëresë nga kryetari i bashkisë së zonës.

Kur pritet që të bëhen këto ndryshime në ligjin për emigracionin dhe nënshtetësinë?

Projektligji është dërguar për shqyrtim në komisionet e parlamentit grek dhe pritet që të miratohet në të njëjtë në fuqi.



Rikonstruktiohet biblioteka nr. 4 në kryeqytet

Eshtë rikonstruktuar plotësisht biblioteka Nr. 4 në kryeqytet, e cila do të mbajë emrin e gjuhëtarit dhe përkthyesit të njohur shqiptar, Petro Zheji. Tashmë ajo ofron një hapësirë moderne për komunitetin e zonës e është pasuruar edhe me një fond të ri prej më shumë se 600 librash. Kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj tha se pas rikonstruksionit biblioteka do jetë një shtytë e madhe për të rinjtë që duan t'i kthehen leximit e theksoi më tej se një investim i tillë është në të mirë të dijës e të ardhmes. "Duhet të këmbëngulim që civilizimi që përfaqësojmë, i librave, i dijës, i të qenit konstruktiv pozitiv, i të qenit me energji të mirë, duhet ta fitojë luftën me industrinë e basteve, lotove",-tha Veliaj. Ky i fundit shtoi se së shpejti do të nisë fushata e librave për 8 bibliotekat e reja të Tiranës.

MINISTRI

Klosi: Aplikoni për mbështetje financiare

Modeli i ngritur në fshatin Seferan, një nga 100 fshatrat turistikë tashmë është një xitje për të gjithë fshatrat e zonës. Ministri Klosi i njohu banorët e zonës me fondet në dispozicion të agroturizmit gjatë një takimi me komunitetin. Kreu i Turizmit dhe Mjedisit u bëri thirrje banorëve të aplikojnë për mbështetje financiare pikërisht nga fondet shtetërore të agroturizmit. Këtë mbështetje financiare që shkon deri në 200 milion lekë të vjetër për çdo përfitues, e marrin ata që zhvillojnë një produkt tradicional shqiptar, apo ngrënë strukturat turistike me karakteristika lokale. "Zonat rurale duhet shndërrohen në destinacione të vërteta ekonomike dhe bashkia e Belshit me pasuritë natyrore që zotëron ka të gjitha mundësitë për t'u shndërruar në një nga pikat më turistike të vendit"- tha ministri Klosi

DEBATI

TEATRI KOMBËTAR

Boriçi: Po i vënë buldozerin “Kadri Roshit”, nuk pranoj të gdhihem hoxhë e të ngrysem prift

Fatmira Nikolli

A e dini se ajo që duan t'i vënë buldozerin te Teatri Kombëtar është salla “Kadri Roshi”? Aktori Dritan Boriçi është një prej atyre artistëve që në muajin shkurt firmosën një peticion ku kërkonte dialog me ministrin e Kulturës.

Nuk e pati kurrë atë dialog, sepse ministrja nuk shkoj kurrë në Teatrin Kombëtar për t'u takuar me artistët. Kur Zoti nuk ta përkrah një çështje të dërgon këshilltarë të këqij – thuhet në një nga librat e shenjtë. Kujtoj këtu ulërimat e qehajait të Teatrit Kombëtar, i cili në një studio televizive ulërinte: “Si të shkojë ministrja atje që të hidhni parulla kundër qeverisë ju”, thotë Boriçi. Prej shkurtit ka kaluar më se një muaj, në fakt, nga debati po bëhen dy, është premtuar një projekt nga kryeministri, aktorët janë kundër, janë mbledhur së bashku sërish, do takohen edhe sonte. Kur e pyes Boriçin, për projektin e ri, thotë që e injoron, por nuk pranon humbje truallit. Thotë se vete jeton në një shtëpi të vjetër, të mbajtur mirë, siç është mbajtur mirë Teatri Eksperimental, ngjitur me Kombëtarin. Ai madje sugjeron që duhet pyetur ministria pse nuk është investuar në TK.

Për Dritan Boriçin, për një teatër të denjë duhet: “T'i duash dhe shokët e kolegët e mi që nuk janë ngritur për xhepin e tyre edhe pse shantazhohen nga sistemi i kontratave që nxori gomerët përpara kuajve në TK, apo për heqjen e pagesave për cilësinë artistike, apo për mohimin e borxheve, apo për daljen nga Unioni Europian i Teatrit”.

Ndiqni intervistën e tij për “Gazeta Shqiptare”.
- **Z.Boriçi, a e keni ndjekur protestën e artistëve për çështjen e TK-së? A keni qenë me ta?**

Sigurisht që kam qenë me ta në çdo tubim. Jam një ndër 90 firmëtarët e atij peticioni që në thelbin e vet kërkonte dialogun me ministrin e Kulturës së Republikës sime. Dialog që befasisht na u refuzua vetëm pse

Aktori: Dialogu me ministrin mungoi, se kur Zoti nuk të përkrah, të dërgon këshilltar të këqij



Aktori, Dritan Boriçi

ne kërkuan të bëheshin sallën e TK. Jam i bindur që nëse ai dialog do të realizohej gjërat nuk kishin për të shkuar deri këtu. Zonja Kumburo kish për ta ruajtur dhe ridimensionuar statutin e saj si mikeshë e artistëve që vërtetë si asnjë ministër tjetër më parë nuk lë asnjë shfaqje pa ndjekur dhe pa u ngjitur deri në kabinat e aktorëve për t'i përshëndetur pas shfaqjes, e cila vërtetë ka kontributet e saj të pamohueshme në tekstet dramatike reformuese për teatrin. (Kujtoj përkthimin e mrekullueshëm të “Në pritje të Godos” nga Beket)

Por kur Zoti nuk ta përkrah një çështje të dërgon këshilltarë të këqij – thuhet në një nga librat e shenjtë. Kujtoj këtu ulërimat e

qehajait të Teatrit Kombëtar, i cili në një studio televizive ulërinte: “Si të shkojë ministrja atje që të hidhni parulla kundër qeverisë ju.”!

- **Si aktor që keni luajtur në atë skenë cili është qëndrimi juaj: a duhet ruajturi godina? A duhet shembur?**

Të parët e mi dhe babai im kanë qenë inxhinierë ndërtimi. Unë kam lindur në një shtëpi dykatëshe me shumë oda dhe ballkone e ndërtuar më 1913. Është ende në këmbë falë kujdesit të banorëve të saj dhe veçanërisht atij që ka qenë në krye të familjes.

Nëse 70% e këtij kompleksi, e kam fjalën për Teatrin Eksperimental, punishten e marangozëve, palestren dhe dhomat e papërfunduara të

“Nuk kam jam pjesë e bisedimeve, trualli i teatrit është gracka ku shpirti i mbretit kapet si laraska”

miqtë e mi Agim Qirjaqi, Roland Trebicka dhe Fatos Sela?

A e dini se ajo sallë së cilës duan t'i vënë buldozerin e ka emrin “Kadri Roshi”?

- **Si ju duket projekti i ri për Teatrin Kombëtar? A është godinë e denjë për një teatër kombëtar dhe a ia vlen me truallin që humbet?**

Kush e pa! Unë dhe disa të tjerë kolegë të mi, të Teatrit Kombëtar kemi qenë të privuar nga njohja e projektit edhe pse sa herë më është kërkuar të formatoj dhe realizoj projekte të rëndësishme të Teatrit Kombëtar dhe Ministrisë së Kulturës nuk i kam kursyer kontributet e mia dhe ata nuk i kanë kursyer ditirambet e tyre. Sigurisht që gjithsecili zgjedh të ngjashmit e vet. Nuk e kam parë ndaj e injoro opinionin për të.

Sa për truallin, (trualli është gracka ku shpirti i mbretit kapet si laraska) dhe kaq sa ka, 6000 metra katror – jo 3000, jo 3000, dhe kaq sa ka është pak. Qenkan dhe ca metra të bashkisë mbrapa teatrit, t'ia japin Teatrit se dimë çfarë ti bëjmë.

- **Ka pasur artistë që janë ndjerë të fyer nga deklaratat e kryeministrit për ta, për nivelin e aktorëve që sipas tij nuk janë si ata të 90-ës dhe deri te pyetja “ç'plasje kanë”. Ligjërimi publik a flet për debat a për monolog?**

Siç është e mirëditur në komunitetin e aktorëve

kryeministri nuk shquhet si ndjekës i teatrit shqiptar. Besoj se nga aktorët e diplomuar të pas '90-ës ai një vetëm drejtorin aktual të Teatrit Kombëtar (zgjedhur dhe vlerësuar nga kryeministri si i tillë), i cili konsiderohet nga brezi i tij si një aktor mediokër dhe pa ndonjë vlerë të veçantë. Sigurisht që duhet ta respektojmë kryeministrin në referencat e veta. Sa për atë se ç'plasje kanë, patjetër janë refleksione nga ky lloj modeli...

- **Keni qenë ju pjesë e ndonjë diskutimi a bisedimi për teatrin?**

Jo nuk kam qenë pjesë e atyre që u gdhinë hoxhë dhe u ngrysen prift.

- **Çfarë duhet bërë për një teatër të denjë për kushtetona?**

TA DUASH TEATRIN. Të duash ato zonja dhe zotërinj që në atë maj të largët të pas Luftës së Dytë Botërore në këtë sallë i injektuan mendësisë shqiptare kulturën e teatrit si cilësi bazike e asaj që quhet kultura e kontinentit tonë European. Ta rikonstruktosh dhe ta ruash atë sallë ku gjenia e këtij popull, në atë kohë shumë të varfër, u ngjit në skenë dhe e transformoi në teatër kombëtar. Të duash dhe respektosh kontributin ndër vite të njerëzve të teatrit që ia pasuan njëri-tjetrit këtë gjini kaq emancipuese për kombin. T'i duash dhe shokët e kolegët e mi që nuk janë ngritur për xhepin e tyre edhe pse shantazhohen nga sistemi i kontratave që nxori gomerët përpara kuajve në TK, apo për heqjen e pagesave për cilësinë artistike, apo për mohimin e borxheve, apo për daljen nga Unioni Europian i Teatrit, etj.

Ndërtimi i një Teatrit të ri të kombit shqiptar; në një truall tjetër, duke e ruajtur dhe nderuar këtë që ekziston, kërkon një konsensus të gjerë dhe konsultime të shumta me specialistë dhe arkitektë të skenave teatrore që të kulmojë me një konkurs ndërkombëtar ashtu siç na është premtuar nga kryeministri vite më parë. Tirana i ka të domosdoshme më shumë teatro. Kur të vendosim të bëjmë godinën dinjitoze të Teatrit Kombëtar duhet të jetë festë, jo grindje, mashtrim, mosbesim, përçarje dhe të shara. Askush nuk duhet të jetë i përjashtuar nga kjo festë.



Projekti i Teatrit Kombëtar



Teatri Kombëtar

SHKRIMTARET DHE ARTISTET NE DIKTATURE

Së shpejti libri më i ri "Shkrimtarët dhe artistët në diktaturën komunist" i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi

Raporti sekret: Sherif Merdani thotë "na u qelb vetja në skenë me këtë lloj muzike"

Ekskluzive/ Zbulohet raporti sekret i vitit 1973, Xega informon Komitetin Qendror për "parullat armiqësore" e arrestimin e këngëtarit

DASHNOR KALOÇI

Menjëherë pas fjalimit të Enver Hoxhës më datat 15 e 16 mars të vitit 1973 në aparatën e Presidiumit të Kuvendit Popullor, ku si objekt dhe temë kryesor ishte: "Lufta ndaj shfaqjeve të huaja e liberale në art e kulturë dhe ndikimi i tyre në të gjithë jetën e vendit...", fjalim i cili e kishte marrë shtysën nga Festivali i 11-të Kombëtar i Këngës në Radio-Televizion, që sapo kishte përfunduar në janar të atij viti, në të gjitha institucionet kulturore e artistike të Tiranës dhe të të gjithë vendit u mbajtën mbledhje të shumta, ku u "punua" ajo fjalë sipas orientimeve përkatëse që vinin nga aparati i Komitetit Qendror të PPSH-së. Fjala e Enver Hoxhës u "punua" jo vetëm në institucionet kulturore dhe artistike, por në të gjitha "kolektivat punonjës" dhe organizatat bazë e komitetet e partisë në të gjitha rrethet e vendit, ku u analizuan "me laps në dorë" puna që ishte bërë deri në atë kohë prej tyre dhe detyrat që u dëllnin për të ardhmen. Kjo gjë veç të tjerash bëhet e ditur edhe nga ky dokument arkivor, që mban datën 22 qershor të vitit 1973, ku sekretari i parë i Komitetit të Partisë së rrethit të Librazhdit, Marko Xega, (me origjinë vllas, nga Korça), informon Komitetin Qendror të PPSH-së, mbi "Disa parulla armiqësore", që qarkullonin në rrethin ku ai drejtonte punën e partisë. Nisur edhe nga një sërë dokumentesh të tjera arkivore që i përkasin kësaj periudhe kohe, situata që paraqet në informacionin e tij sekretari i parë i rrethit të Librazhdit është pak a shumë e njëjtë edhe me ato të rretheve të tjera të vendit, ku përveç "parullave armiqësore" ka pasur edhe hedhje traktesh e fletushkash po me "përbajtje armiqësore" si në Korçë, Shkodër, Peshkopi, etj. Dhe të gjitha këto informacione, deri të detajuara, mbushnin përditë skrinin e Enver Hoxhës. Gjë e cila me shumë gjasa e ka frikësuar atë për një "rreshqitje të situatës" nga dora dhe e ka detyruar Enverin që të mbante fjalimin e famshëm të 15 e 16 marsit në Presidiumin e Kuvendit Popullor, i cili i parapriu atij në aparatën e Komitetit Qen-



Sherif Merdani

dror të PPSH-së dhe Plenumin e IV. Ajo që vihet re në raport-informacionin e sekretarit të parë të rrethit të Librazhdit, ndryshe nga ato të shumë rrethëve të tjera, është se aty përmendet me emër e mbiemër, vetëm Sherif Merdani, i cili sapo ishte arrestuar për "krimin e agjitacionit e propagandës" ndërsa për rastet e tjera, edhe jo të asaj natyre, flitet vetëm në parim dhe pa përmendur asnjë emër. Pra, aty goditja është përqendruar vetëm ndaj Sherif Merdanit, i cili në atë kohë ishte me punë në Shtëpinë e Kulturës së atij rrethi. Po të kthehemi në kohë dhe ta gjykojmë atë raport-informacion sipas logjikës së asaj periudhe kur ai është shkruar, themi se ai ka qenë tepër "korrekt", pasi në qytetin e Librazhdit, "shfaqjet e huaja dhe ndikimi i ideologjisë së huaj borgjeze dhe revizioniste" nuk mund të kërkoheshin tek grupi i burrave që kërcente "vallen e Rrajcës", apo ai të "vallja e pipzave", pasi dihet se ato "ishin mbështetur fort në traditën dhe tabanin popullor", por ajo gjë, pra; "shfaqjet e huaja liberale", do të kërkoheshin tek Sherif Merdani, i cili sapo ishte kthyer nga Festivali i 11-të i Këngës në Radio-Televizion, (festival që ishte anatemuar nga

Enver Hoxha), kishte bërë një emër të madh në Tiranë dhe në rrethet, ku ishte mjaft i kërkuar nga rinia që e adhuronte, djalë simpatik që vishej bukur dhe ndiqte modën e huaj, aty në Librazhd këndonte me kitarë dhe kryesisht këngë të huaja, vinte nga një familje e pasur qytetare nga Korça dhe me probleme me regjimin (nga familja Merdani ishin disa në burgjet politike), apo siç thuhet në atë kohë, me prejardhje nga "klasat e përmbysura". Dhe nisur nga të gjitha këto dhe jo vetëm, Komiteti i Partisë së Librazhdit, ishte "në rregullim" me goditjen dhe arrestimin ndaj Merdanit, pasi ato "kritere" nuk i plotësonte askush tjetër në Librazhd më mirë se ai. Dhe arrestimi e dënimi i tij me burg politik, (ashtu siç do të ndodhte në atë kohë edhe me Minush Jeron, Mihallaq Luarasin etj.) në një farë mënyre "përligje" goditjen që i kish të bërë Enver Hoxha ndaj Festivalit të 11-të, vetëm pak ditë pas përfundimit të tij. Pra me pak fjalë, nuk mund të kritikohet

Po të kthehemi në kohë dhe ta gjykojmë atë raport-informacion sipas logjikës së asaj periudhe kur ai është shkruar, themi se ai ka qenë tepër "korrekt", pasi në qytetin e vogël të Librazhdit, "shfaqjet e huaja dhe ndikimi i ideologjisë së huaj borgjeze dhe revizioniste" nuk mund të kërkoheshin tek grupi i burrave që kërcente "vallen e Rrajcës", apo ai të "vallja e pipzave", pasi dihet se ato "ishin mbështetur fort në traditën dhe tabanin popullor", por ajo gjë, pra; "shfaqjet e huaja liberale", do të kërkoheshin tek Sherif Merdani...

dhe goditje Festivali i 11-të, pa u goditur personazhet kryesorë që e realizuan atë. Por duhet thënë se Sherif Merdanit, nuk i erdhi "e keqja" vetëm nga Librazhdi, pasi ai ishte pikëtuar që në Tiranë për t'u goditur dhe dënuar. Veç të tjerash këtë na e bën të ditur (për herë të parë publikisht në faqet e këtij libri), Prof. Dr. Sadik Bejko, shkrimtar, poet, publicist, ish-deputet, cili në atë periudhë kohe,



Sherif Merdani duke kënduar në Festivalin e 11-të të Këngës në Radio-Televizion

ishte redaktor i teksteve të këngëve në Radio-Tirana dhe kishte një farë shoqërie me Sherif Merdanin. Lidhur me këtë, Sadiku kujton: "Pak ditë pas Festivalit të 11-të, më thirri në zyrë drejtoresha e radios, Nefo Myftiu dhe në konfidencialitet të plotë më tha që ta takoja Sherifin dhe t'i thosha vegmas, të ketë kujdes me ato këngë që këndon andej lart e poshtë nga shkoni, se nuk mundem ta mbroj dot më". Sadiku kujton se e takoi Sherifin dhe ia tha "porosinë" e drejtoreshës dhe përgjigja e tij ishte: "Për Nefo Myftiun, unë hidhem nga kati i pestë". Sadiku ia ktheu: "Ti mos u hidh nga asnjë kat, por mbaje parasysh këtë porosi të saj" dhe aty ai u nda me Sherifin për të mos u takuar më deri në fillimin e viteve '90-të. Pasi siç dihet, Sherif Merdani përfundoi burgjeve të regjimit politik të Enver Hoxhës, sa në Spaç, Burrel, Qafë-Bari e Ballsh, (u ridënuar përsëri në burg) për t'u liruar vetëm në vitin 1990-të, kur regjimi komunist ishte në agoninë e tij. Ashtu si edhe pjesa më e madhe e dokumenteve të këtij



Konferencieri i Festivalit të 11-të, Bujar Kapexhiu



libri, edhe ky publikohet i plotë dhe pa asnjë shkurtim.

PARTIA E PUNES E SHQIPERISE
SEKRET
KOMITETI I PARTISE SE
RRETHIT EKZ. NR. 1

LIBRAZHD Librazhd, më 22/6/1973

Lënda: Informacion mbi disa parrulla armiqësore
KOMITETIT QENDROR
P.P.SH. TIRANE

Gjatë muajit maj dhe ditët e para të muajit qershor 1973 në rrethin tonë kemi pasur disa parrulla armiqësore kundër Partisë dhe pushtetit. Kryesisht këto parrulla

Enver Hoxha në qoftë se është i mençur duhet ta dorëzojë vetë detyrën, se do të vijë dita ta shkarkojnë vetë shokët e tij.

Ata të qeverisë tani po ndajnë se populli nuk i don, prandaj flasin vetëm për gatishmëri dhe vigjilencë. Punët nuk shkojnë mirë, se edhe të mëdhenjtë po grinden me njëri-tjetrin. Në Byronë Politike ka grindje dhe nuk ka unitet. Kështu ka kundërshtuar Fadil Paçrami, pra ka debate, grindje, përçarje. Fadil Paçrami e Todri Lubonja kanë qenë njerëz me pozita, por u shkarkuan se ishin bërë të pakënaqur dhe nuk e duan këtë parti, ashtu siç nuk e do dhe populli. Masa e marrë për ta nuk është e



Librazhdi


kanë të bëjnë me fjalimin e shokut Enver të 15 marsit 1973 dhe problem të tjera.

Disa nga parullat kanë qenë në këto drejtime: Këta na mburren se kanë dritë elektrike, por shtetet e tjera e kanë bërë më parë këtë gjë të tillë. Hejja e antenave të televizorëve u bë me të vetmin qëllim që populli të mos dijë dhe të merret vesh se çfarë bëjnë shtetet e tjera. Enver Hoxha e ngriti këtë problem më 15 mars dhe këto nuk janë gjë tjetër veçse masa shtrënguese dhe

drejtë se ata janë koka të mëdha, se vendi ynë duhet të eci me kohën dhe vendet e tjera të Europës dhe nuk duhet të rrinë mbrapa dhe masat që janë marrë dhe po merr Partia, janë shumë të rrepta dhe këto janë kufizime lirie që i bëhet populli.

Punojmë gjithë ditën, por nuk marrim gjë dhe tani jemi bërë si bagëtitë, porse kjo nuk do të zgjasë shumë etj.

Revolucioni kultural në Kinë ka qenë një bluf se Kina e ndry-



shoi qëndrimin e saj. Ajo u lidh me Amerikën. Mao Ce Duni nuk ekziston dhe vendin e tij e luan një aktor. Shtetet e tjera janë shumë të forta, kanë armatime që nuk i kemi etj. Ka pasur edhe raste që kanë thënë se na u qelb vetja duke dalë në skenë me këllë muzikë dhe tani ndihet vetëm duart etj. Kjo janë shprehur nga Sherif Merdani, i cili për krimet kundër shtetit në formën e agitacionit e propagandës ditët e fundit është arrestuar.

Këto parrulla janë bërë nga elementë keqbërës dhe armiq, të cilët janë në përpunim. Nga këto me kemi nxjerrë detyrat tona. Sipas rasti në takime me sekretarët e organizatash bazë, kuadro, popull si në fshat ashtu dhe në qytet, në zona të ndryshme kemi folur për kujdesin që duhet të tregojmë, për rritjen e vigjilencës, për të goditur çdo shfaqje të huaj armiqësore. Mëqenëse këto janë në përpunim nuk kemi përmendur emra. Mendojmë që mbasi të arrestohen edhe dy të tjerët, do të bëjmë edhe demaskime publikisht.

Është për t'u theksuar se kohët e fundit megjithëse të pakta, por ka sinjalizime edhe nga organizatat bazë të partisë. Kështu ka qenë rasti nga byroja e organizatës bazë të partisë në kooperativën e bashkuar Hotolisht, se një grua nga familja e saj me qëndrim jo të mirë politik desht të mbillte një pemë në ish-arën e saj dhe kur i është thënë se përse e mbjell, ajo është përgjigjur se është ara time dhe do të vijë dita jonë. Kjo u kap menjëherë nga organizatat bazë dhe vetë brigada dhe u demaskua në popull.

Gjithashtu, kemi pasur edhe disa raste të zbutjes së luftës së klasave. Kështu, në katundin Funares dy komunistë, njëri kryetar i këshillit të fshatit bashkuar dhe tjetri, zv/sekretar i organizatës bazë të partisë dhe arsimtar, fill mbosi bënë konkluzionet e fjalës së shokut Enver të 15 marsit, shkojnë për darkë në dhëndurët e kulakut (dy vëllezër, kanë marrë dy bijat e kulakut) dhe aty ia shtrajnë me të ngjyra dhe me të pira, me doli, kanë marrë nëpër gojë komunistët e tjerë, ku mbas pjes dhe janë rrahur. Raste të pirsjes dhe të zbutjes së luftës së klasave këta kanë pasur edhe herë të tjera dhe janë këshilluar nga organizata bazë, por ata nuk kishin nxjerrë mësim. Një kandidat partie u martua me të bijën e ish-kulakut, të dy djemtë e tij kanë qenë në burg.

Këto raste u analuan në byronë e Komitetit të Partisë rrethit dhe karshi tyre u mbajt qëndrim duke i përjashtuar nga partia. Është për t'u theksuar se këtë vendim të Byrosë Komitetit Partisë, masa e popullit e ka pritur mirë.

Gjatë kësaj kohe kemi pasur edhe thashetheme dhe intriga në zona të ndryshme për të futur grindje e përçarje, në këto ka pasur edhe komunistë, siç është rasti i sekretarit të organizatës bazë të fshatit Rrajçë, i cili me qëllim që të diskreditojë brigadierin, njëri shumë i ndershëm dhe që kërkon llogari, duke mos bërë lëshime, shpif kundër tij për marrëdhënie me një shoqe të brigadërës. Vetë brigada e demaskoi. Organizata bazë u mblodh menjëherë dhe mbajti qëndrim ndaj tij, duke e kthyer nga anëtarë në kandidat partie. (Byroja e Komitetit të Partisë akoma nuk ka vendosur).

Nga këto dhe raste të tjera ne ia kemi bërë problem jo vetëm të organizatës bazë të partisë, por edhe të popullit. Një gjë është pozitive se kur i shtron drejt në popull, ay jo vetëm të kupton drejt, por edhe mban qëndrim të drejtë.

Më datën 16 qershor 1973 në rrethin tonë u zbuluan dhe u kapën dy persona nga shokët e Degës së Brendshme të rrethit tonë në bashkëpunim edhe me disa punonjës të tjerë të ndërmarrjes së ndërtimit dhe fshatarë të fshatrave Lunik, Zdrajsh e Funarë, që kishin vjedhur bankën e Belshit në rrethin e Elbasanit. Të dy këta persona janë nga rrethi tonë. Është për t'u theksuar se Dega e Punëve të Brendshme të rrethit të Elbasanit nuk kishte vënë fare në dijeni Degen e rrethit tonë për ngjarjen e Belshit. Kapja u bë se për ta dyshohet si njerëz jo të mirë dhe që vitin e kaluar kanë patur tentative arratisjeje. Bashkë me personat që u arrestuan, u gjetën edhe 240.000 mijë lekë. Hetimet vazhdojnë.

Për të gjitha këto probleme, ne kemi nxjerrë detyrat tona duke intensifikuar punën politike dhe ideologjike, me qëllim për t'u prerë rruga shfaqjeve të tilla.

SEKRETARI I K.P. RRETHIT
Marko Kega

Kapet ish-presidenti i Katalonjës pas vizitës zyrtare në Finlandë

U përpoq të largohej nga vendi, arrestohet Puigdemont

Organizoi trazirat në Spanjë, në pranga autori

Ish-presidenti i Katalonjës, Carles Puigdemont është arrestuar ditën e shtunë nga policia finlandeze, pas lëshimit të një urdhër arresti nga autoritetet europiane. Puigdemont, i cili është i strehuar në Belgjikë si azilkerkues, ndodhej në Finlandë për një vizitë zyrtare. Urdhri i arrestit ndaj tij është lëshuar nën akuzën e organizatorit të trazirave në ndodhura në Katalonjë vitin e shkuar. Verën e kaluar, qytetarët e Katalonjës u ngritën në demonstrata masive, duke kërkuar pavarësinë e vendit nga Spanja. Parlamenti katalanas ka votuar për të shpallur pavarësinë nga Spanja. Më parë parlamenti votoi me 70 vota pro dhe 10 kundër. Kryeministri spanjoll Mariano Rajoy më herët i tha Senatorëve se ishte nevoja për sundim të drejtpërdrejtë për të kthyer "ligjin, demokracinë dhe stabilitetin" në Katalonjë. Kriza filloi kur katalanasit votuan me referendum për pavarësi nga Spanja, votim, i cili u shoqërua me mjaft trazira dhe u plagosën rreth 900 persona. Një urdhërarrest i evropian u lëshua për ish-presidentin katalanas Carles Puigdemont. Por më vonë gjykata vendosi ta tërheqë atë. Gjykata shpërgoi se Puigdemont ka shprehur gatishmërinë për t'u kthyer në Spanjë, krahas katër anëtarëve të tjerë të kabinetit të tij, të cilët u arratisën në Belgjikë pas referendumi të pavarësisë. Pesë politikanët udhëtuan



Ish-presidenti i Katalonjës, Carles Puigdemont

në Belgjikë, pasi deklaruan pavarësinë për Katalonjën pas një referendumi në tetor. Deklarata u konsiderua e paligjshme nga parlamenti spanjoll. Ndërsa, Puigdemont iu tha se do të duhet të presë deri në mes të dhjetorit për një vendim nga Brukseli nëse do ta ekstradojë ose jo në Spanjë për t'u përbal-

lur me gjyqin. Karlos Puigdemont, qeveria rajonale e të cilit është rrëzuar nga Madridi, ka ikur në Belgjikë dhe nuk ka pranuar të kthehet në Spanjë për të marrë pjesë në një seancën gjyqësore për akuzat për rebelim dhe kryengritje. Autoritetet spanjolle thanë se Puigdemont dhe anëtarët e tjerë të

qeverisë së tij e thyen ligjin për shkak të thirrjes së tyre për një referendum të pavarësisë për Kataloninë dhe një deklaratë pasuese të pavarësisë, shkruan "The Independent". Duke folur në Madrid, presidenti i gjykatës Carlos Lesmes tha: "Kur dikush nuk shfaqet pasi është thirrur nga një gjykatës për të

ISH-PRESIDENTI

Karlos Puigdemont, qeveria rajonale e të cilit është rrëzuar nga Madridi, ka ikur në Belgjikë dhe nuk ka pranuar të kthehet në Spanjë për të marrë pjesë në një seancën gjyqësore për akuzat për rebelim dhe kryengritje.

dëshmuar, në Spanjë ose në ndonjë vend tjetër të BE-së, zakonisht lëshohet një urdhërarrest". Ndërkohë Puigdemont tha se ai dhe kolegët e tij do të qëndronin në Bruksel "të mos shmangin drejtësinë, por të kërkojnë atë", duke kritikuar dënimet e planifikuara të gjykatës spanjolle.



Zgjidhen kryetarët e parlamentit në Itali, por jo qeveria

Deputetët italianë ditën e djeshme kanë zgjedhur kryetarët e dy dhomave të parlamentit, të dalë nga zgjedhjet e 4 marsit, në të cilat asnjë parti nuk arriti një fitore absolute. Besimin për të kryesuar me dy dhomat e parlamentit e morën lëvizja Pesë Yjet dhe Forza Italia, transmeton Anadolu Agency. Maria Elisabetta Alberti Casellat, pjesëtare e Forza Italia, njëherësh një aleate shumëvjeçare e Silvio Berlusconi-t, u bë grujaja e parë e zgjedhur për kryetare e Senatit Republikan, edhe atë në rrethin e dytë të votimit. Roberto Fico nga lëvizja Pesë Yjet është zgjedhur kryetar i Dhomës së Përfaqësuesve. Pavarësisht zgjedhjes së dy kryetarëve të parlamentit, akoma nuk ka tregues se njëra nga dy partitë me numrin më të madh të deputetëve, Pesë Yjet dhe koalicioni i qendrës së djathtë i tubuar rreth Forza Italia, janë afër formimit të qeverisë. Pritet që javën e ardhshme të mbahen negociata për të arritur deri të shumica e nevojshme për mbështetje të qeverisë.

Mediat greke: Palët ende nuk kanë shfaqur pajtueshmëri

Konflikti prej 27 vitesh për emrin e Maqedonisë, bisedimet zhvendosen në Vjenë



Skai, sqaroi se për Greqinë, ndryshimi i Kushtetutës është parakusht për çfarëdo lloji zgjidhjeje. Gazeta "Ta nea" shkruan se nëse dikush dëshiron të dalë në një përfundim nga vizita historike e Kotzias në Shkup, ky kon-

statim do të jetë se të dyja palët janë larg arritjes së marrëveshjes. Kotzias çoi në Shkup atë që u lakua si zgjidhje kompromisi për çështjen e emrit. "Gorna Makedonija" -Maqedonia e Epërme, u duk se do të ishte

formula magjike, me të cilën do të zgjidhet pas 27 vjetësh konflikti për emrin mes Greqisë dhe Maqedonisë. Pala greke kërkon që nocioni sllav të mos përkthehet, por këtu kompromisi duket se është i vështirë.



Donald Trump ndalon transgjorët në ushtri

Presidenti Donald Trump ka nxjerrë një urdhër që ndalon shumicën e transgjorëve që të shërbejnë në ushtri, me përjashtim të "rrethanave të kufizuara". Në një deklaratë nga Shtëpia e Bardhë thuhet se sekretarët e mbrojtjes dhe sigurimit "kanë arritur në përfundimin se aderimi ose mbajtja e individëve me një histori ose diagnozë të disforisë gjinore - ata që mund të kërkojnë trajtim të konsiderueshëm mjekësor, paraqesin rrezik të konsiderueshëm për efektivitetin ushtarak". Presidenti premtoi vitin e kaluar të bllokonte transgjorët të shërbenin në ushtri, një lëvizje që përmbyste politikën e presidentit Barak Obama për pranimin e tyre. Lëvizja e presidentit Trump megjithatë është bllokuar nga disa sfida ligjore, dhe Pentagoni filloi të lejonte rekrutet transgjorë që të regjistroheshin në ushtri në janar. "Disforia gjinore", e njohur dikur si çrregullim i identitetit gjinor, përcaktohet nga ndjenjat e forta dhe të qëndrueshme të identifikimit me gjininë e kundërt, gjë që rezulton në shqetësime apo dëme të konsiderueshme.

TRUMP

Presidenti premtoi vitin e kaluar të bllokonte transgjorët të shërbenin në ushtri, një lëvizje që përmbyste politikën e presidentit Barak Obama për pranimin e tyre.



MJEKU YLLI MERJA



Si të shkrini gurët në tëmth me bimët mjekësore

KESHILLA



Luftoni stresin e ankthin me bimën e vjeshtullës

Altin Çekodhima:



◆ Mjeku gastroenterolog: Fatkeqësisht simptomat shfaqen në stadi shumë të avancuara

Pirja e duhanit, rrezik i dyfishtë për kancerin në stomak

"Meshkujt, tri herë më të predispozuar ndaj sëmundjes"

• Mënyra praktike për të parandaluar alergjitë e stinës

Mjeku gastroenterolog: Fatkeqësisht simptomat shfaqen në stade shumë të avancuara

Altin Çekodhima:

Pirja e duhanit, rrezik i dyfishtë për kancerin në stomak

‘Meshkujt, tri herë më të predispozuar ndaj sëmundjes’

Voltiza Duro

Kanceri i stomakut po merr përmasa të mëdha në vendin tonë e është shkaktar për një numër të konsiderueshëm të vdekjeve. Rreziku për tu prekur nga sëmundja, është dy herë më i lartë te personat që konsumojnë duhanin. Në një intervistë për suplementin “Life Pages” në “Gazeta Shqiptare”, mjeku gastroenterolog dhe endoskopisti, Altin Çekodhima tregon se meshkujt janë tri herë më të predispozuar për t’u prekur nga kanceri i stomakut, dhe krahasuar me femrat, gjithashtu, bën me dije se moshat më të riskuara janë ato 40-65 vjeç. Sipas mjekut pacientët me kancer të stomakut shpesh i shfaqin simptomat në stade shumë të avancuara.

Cilët janë disa prej shkaktarëve që ndikojnë në shfaqjen e kancerit të stomakut?

Kanceri i stomakut është një ndër tumoret malinjë më të shpeshta, përgjegjës për një numër të madh vdekjesh në vit në Shqipëri. Infeksiioni Helikobakter Pylorit mendohet se është një nga shkaktarët e shumicës së kancerëve të stomakut ndër-
sa gastriti atrofik autoimun, metaplazia intestinale dhe një sërë faktorësh të tjerë gjenetikë shoqërohen me rritjen e rrezikut për kancer në stomak. Shoqata Amerikane e Kancerit paraqet një listë të faktorëve të lidhur me dietën ushqimore (mishi, peshku i kripur dhe i tymosur dhe ushqimet e konservuara), nitratet dhe nitritet, të cilat gjenden kryesisht në mishin e konservuar rrisin rrezikun për kancer të stomakut.

Sa ndikon pirja e duhanit apo alkoolit në zhvillimin e sëmundjes?

Një faktor shumë i rëndësishëm që shkakton kancer të stomakut është pirja e duhanit. Ky faktor rrit rrezikun për kancer nga 40% te personat që e pinë në sasi të vogël, deri në 82% tek ata që e pinë duhanin për një kohë të gjatë, që do të thotë se dyfishohet rreziku për kancer në krahasim me personat që nuk e pinë duhanin. Alkooli është një shkak tjetër që rrit rrezikun për kancer, sidomos kur është i shoqëruar me duhanpirje.

Cilët janë më të predispozuar për t’u prekur nga kanceri i stomakut?

Kanceri i stomakut prek më shumë meshkujt se femrat, në një raport 3 meshkuj 1 femër. Estrogeni si hormon femëror mund të mbrojë gratë nga ky lloj kanceri.



Mjeku gastroenterolog dhe endoskopisti, Altin Çekodhima

Shumica e pacientëve të diagnostikuar me kancer të stomakut janë të moshuar. Moshë e mesme është ndërmyet 40-65 vjeç. Diagnostikimi i kancerit tek moshat e reja ka qenë në format më agresive.


Cilat janë disa prej simptomave që shfaqin të sëmurët?

Shenjat dhe simptomat kanceri të stomakut përfshijnë: dhimbje abdominale (e barkut); humbje të pashpjegueshme në peshë dhe humbje të oreksit; dhimbje e papërcaktuar e barkut zakonisht sipër kërthizës; ndjesia e fryrjes së tepërmi pas një vakti të lehtë; djegie kraharori, urth ose shenjat e një ul-
cere, nauzea, të vjella me ose pa gjak si dhe ënjtje e barkut për shkak të grumbullimit të lëngjeve në kavitetin abdominal. Ndërkaq, humbja në peshë dhe dhimbjet e vazhdueshme janë shenjat më të shpeshta të kancerit. Dhimbja e barkut fillimisht mund të jetë e lehtë, por ajo forcohet me progresin e kancerit. Pacientët, gjithashtu, mund të shfaqin të vjella ose ndjenjën e mb-

ingopjes për shkak të masave kanceroze, të cilat zënë një pjesë të madhe të hapësirës së stomakut.

Si kryhet diagnostikimi i sëmundjes dhe në cilin stad paraqiten pacientët te mjeku?

Diagnostikimi i hershëm është i vështirë, sepse simptomat bëhen të pranishme kur situata ka përparuar. Mundësia e kurimit varet nga koha kur diagnostikohet kanceri. Sa më herët të kapet aq më shumë përfiton pacienti. Me video-endoskopi sidomos në ditët e sotme me aparatura të avancuara me rezolucion të lartë,



STADET E SËMUNDJES

- Stadi 0. I limituar vetëm në shtresën e mukozës së stomakut. Trajtohet me endoskopi duke bërë heqje të shtresës të mukozës (pa operacion të hapur).
- Stadi I. Penetrimi në shtresën e dytë nga tre shtresa të stomakut (Stage 1A), ose prekja e shtresës së dytë dhe gjëndrave limfatike që janë përreth murit të stomakut (Stage 1B). Stadi 1A trajtohet me kirurgji ku përfshihet edhe heqja e omentumit. Stage 1B mund të trajtohet me kimioterapi (5-fluorouracil) dhe terapi me radiacion.
- Stadi II. Penetrimi në shtresën e dytë dhe në gjëndrat limfatike në distancë, ose në shtresën e tretë dhe në limfonodujt (gjëndrat limfatike) në afërsi, ose kur preken të katër shtresat e stomakut por pa prekur limfonodulat. Trajtimi bëhet si në stadin e parë por nganjëherë shtohet kimioterapia me neoadjuvant.
- Stadi III. Penetrimi në shtresën e tretë dhe prekja e gjëndrave limfatike në distancë, ose prekja e të 4 shtresave të stomakut si dhe e limfonodulave të afërta. Trajtimi bëhet si në Stadin II. Në disa raste është ende e mundur një kurë.
- Stadi IV. Kanceri është i shpërndarë në indet e afërta dhe në gjëndrat limfatike në distancë si dhe ka metastaza në organet e tjera. Në këto stade kura ndikon shumë pak.

mundësohet një ekzaminim i imtë-sishëm dhe vlerësim i situatave që në stadet fillestare. Fatkeqësisht, pacientët me kancer të stomakut shpesh kanë simptoma në stade shumë të avancuara. Kjo është një nga arsyt përse kanceri është shumë i vështirë për t’u diagnostikuar që në stadet fillestare.

Si procedohet nga ana juaj me pacientët gjatë diagnostikimit?

Gastroskopia është metoda e zgjedhur ekzaminuese për këtë sëmundje. Gjatë ekzaminimit me gastroskop merret biopsi, e cila dërgohet për ekzaminim histopatologjik ku shihet nga mjeku histopatolog në mikroskop për prezencën e qelizave kanceroze dhe llojin e kancerit. Nëse në ekzaminimin histopatologjik gjenden qeliza kanceroze, hapi tjetër është të gjenden stadi i zhvillimit në varësi të shtrirjes së sëmundjes. Për të bërë stadifikimin e kancerit, d.m.th shtr-

irjen dhe shpërndarjen në distancë të tij, bëhen teste të ndryshme. Duke pasur parasysh që kanceri i stomakut prek dhe organet e tjera si mëlcinë, pankreasin dhe mushkërinë, doktori, për të bërë stadifikimin kryen ekzaminime të tjera shtesë.

Cilat janë disa nga masat për parandalimin e sëmundjes?

Mund të përdoren disa teknika për të zgjatur jetën dhe për të përmirësuar simptomat. Në këto raste bëhet kirurgjia dhe stentet për të mbajtur traktin tretës të lirë prej bllokimit të masës dhe kimioterapi me medikamente si 5-fluorouracil, cisplatin, epirubicin, etoposide, docetaxel, oxaliplatin, capecitabine, ose irinotecan. Nga ana tjetër, ngrënia e frutave dhe zarzavateve të freskëta që përmbajnë vitamina antioksidante (vitamina A dhe C), mendohet se e ul rrezikun për kancer në stomak.



Voltiza Duro

Në përgjithësi gurët në tëmth janë karakteris tikë për femrat që janë të shëndosha, sepse ka lidhje me rregullimet hormonale të tyre. Gjithashtu, gurët në tëmth mund të prekin personat që vuajnë nga ceroza hepatike, ata që marrin mjekim për një kohë të gjatë, individët që kanë kolesterolin e lartë si dhe me ata që dëshirojnë të realizojnë një rënie drastike në peshë brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore. Po të vëmë re, të gjithë kategoritë e personave të sipërpërmendur kanë lidhje me kolesterolin e vetë gurët në tëmth janë lipide e kristalizime të tyre, e këto të fundit mund të ndodhë që të bashkohen e të marrin formën e një guri. Në momentin që lëngu në tëmth nuk qarkullon lirshëm nga fshikëza e tëmthit në kanalin e saj e nuk ka një shkarkim të rregullt të tëmthit, atëherë ndodh që këto substanca të përqendrohen, të kristalizohen e të bashkohen me njëra-tjetrën. Pra në fillim, krijohet një si "mjegull" (pezulli), e më tej llumi, duke u bashkuar me molekulat e kolesterolit krijojnë gurëza të vegjël në tëmth. Nëse personi nuk i kushton kujdes pastrimit të gurëve në fazën që janë 1-2 milimetra (që është periudha më e mirë për ti hequr) atëherë në sipërfaqen e jashtme të gurëve do të vazhdojnë të akumulohen e grumbullohen kristale të kolesterolit ose grimca të llumit biliar të tëmthit. Ky gur pas disa kohësh do të fillojë të marrë një pamje më të madhe, më të plotë, pra do të progresojë rritjen më tej. Nëse guri krijohet vetëm nga lipidet, pra nga kolesterolin ngjyra e tij do të jetë e verdhë, ndërsa kur kemi të bëjmë edhe me një përqendrim të bilës, atëherë këto gurë do të kenë një ngjyrë të kuqërremtë apo kafe në të errët. Ndërkohë në grupin e tretë të gurëve të tëmthit futen ato përbërje që krijohen nga kolesterolit dhe veprimi i lëngut të tëmthit.

SIMPTOMAT
Në përgjithësi, personat që kanë gurë në tëmth në shumicën e rasteve nuk e kuptojnë që kanë një gur në tëmth e madje e zbulojnë rastësisht gjatë kryerjes së ekos. Guri fillon të bëhet i bezdisshëm e të japë dhimbje në rastet kur organizmi kapet nga një infektion, por gjithsesi treguesi më i mirë është edhe goja e thatë, apo ndjesi e hidhur e personit të prekur. Në momentin që ky I fundit konsumon një ushqim me yndyrë të tepërt, mund të ndjejë vajin në grykë, ose ti shfaqet

Mjeku popullor: Si ta kuptoni që jeni prekur nga sëmundja, simptomat e para

Ylli Merja: Si të shkrini gurët në tëmth me bimët mjekësore

“Efektet e mrekullueshme të rigonit e lules së akjes”



Mjeku popullor, Ylli Merja

ndonjë dhimbje e lehtë në krahun e djathtë, poshtë brinjës dhe në shpatull. Këto simptoma janë tipike të pranisë së gurëve në tëmth e rekomandohet që femrat mbi peshë, apo ato që vuajnë nga obeziteti të bëjnë kontrollin të vazhdueshme të mjeku. Ekzaminimi bëhet me eko nëpërmjet së cilës kuptohet praninë e gurëve në tëmth apo jo; si dhe kontrolli i vezikës së tëmthit. Nëse në këtë të fundit, konstatohet se muret kanë filluar të trashen, atëherë krahas gurëve ka dhe infektion të tëmthit, situatë e cila shoqërohet me dhimbje të shumta e kriza të forta. Vlen të theksohet se moshat më të prekura nga kjo sëmundje janë personat e grupmoshës 40-60 vjeç.

TRAJTIMI ME BIMË MJEKËSORE
Në momentin që pacienti kon-



staton praninë e gurëve në tëmth, atëherë patjetër duhet të fillojë trajtimin me bimë mjekësore, në mënyrë që të mos i nënshtrohet një ndërhyrje kirurgjikale. Nëse personi ka një nga simptomat e sipërpërmendura, rekomandohet konsumimi i rigonit. Pra, të hidhet sa më shumë nga kjo bimë në gjellë, dhe do të vini re që përbërësit aktivë të rigonit, jo vetëm do iu lehtësojnë tretjen e do t'u pastrojnë mushkëritë, por edhe do fillojnë të japin efektet e para në shkrirjen e gurit. Llumi do të fillojë të dalë më shpejt kurse gurët do të gërryhen. Gjithashtu, nëse pacientët kanë ndjesinë që ushqimi në muret e stomakut rri i thatë, atëherë duhet të konsumojnë rigonin të kombinuar me mendër pasi janë dy bimë që japin efekte të mrekullueshme në qetësimin e dhimbjeve të tëmthit, nxisin e përmirësojnë funksionin e mëlçisë, bëjnë të mundur të prodhohet më shumë lëng biliar në tëmth si dhe ndihmojnë në shkrirjen e gurëve. Në rastet kur gurët janë më të mëdhenj se 4-5 milimetra, atëherë kombinimi i bimëve të sipërpërmendura nuk kanë më fuqi vepruese dhe duhet të shtohen përbërësit bimorë. Lule akja ka pamjen e një guri në tëmth e përdorimi i saj në kurimin e sëmundjes, është me të vërtetë një sukses i padiskutueshëm, pasi ajo ka aftësinë të nxisë pikimin e lëngut të tëmthit, shkrin gurët e më tej krijon një lloj xheli që gurët të dalin pa dhimbje nga organizmi. Edhe petat e drizës, ndikojnë gjithashtu jo vetëm në shkrirjen e gurëve të tëmthit, por edhe atyre të veshkave.



MENYRA PRAKTIKE për të parandaluar ALERGJITË e stinës

S tina e pranverës sapo ka trokitur, por bashkë me të edhe alergjitë e shumta që mund t'iu shkaktojnë teshtima, skuqje apo lotim të syve. Ndoshta shumë prej jush dëshirojnë të hapin dritaret për të ndjerë filladin pranveror, por kjo mund të mos jetë zgjidhja më e mirë për alergjikët. Më poshtë po japim 10 mënyra të vlefshme që do i ndihmojnë të luftoni alergjitë e stinës e t'i shijoni sa më shumë ditë pranverore.
HANI NJE KIVI ÇDO MËNGJES



Fruti i kivit është i pasur me vitaminë C, e cila vepron si një antihistamin natyral. Disa studime lidhin nivelet e ulëta të vitaminës C në organizëm me alergjitë. Kur ndjeni se alergjia fillon të shfaqet në trupin tuaj, mos harroni të merrni një shtojcë të vitaminës C.
AKTIVIZONI KONDICIONERIN
Kondicionerët kanë aftësinë të kushtëzojnë ajrin, të heqin lagështinë e mykut dhe të filtrojnë alergenat që hyjnë në shtëpi. Vetëm sigurohuni që të pastroni ose të ndryshoni filtrat e kondicionerëve shpesh, në të kundërt mund t'i bëni gjërat më keq. Ekspertët bëjnë me dije se përdorimi i një kondicioneri do të ndihmojë në pastrimin e ajrit në shtëpinë tuaj. Nëse jeni të prirur për t'u prekur nga alergjitë, atëherë duke hapur dritaret, sidomos gjatë natës, mund të keni probleme.
KONSUMONI MISH PULË
Një studim dyvjeçar i 334 të rriturve me alergji faktoi se ata që hëngrën ushqime me një

formë të yndyrës monounsaturatëd gjetur kryesisht në mish dhe produkte të qumështit, kishin pothuajse tre herë më shumë gjasa për të shfaqur shenja alergjike. Kështu që konsumoni më tepër mish pule për të minimizuar alergjinë.
PASTRONI TË GJITHA INSEKTET E VDEKURA
Insektet e vdekura në kohën që fillojnë të trefren, ato mund të bëhen burim alergjike. Personat që morën një shtesë me vaj peshku çdo mëngjes, patën përmirësim të problemeve me alergjinë. Një studim i njerëzve me astmë alergjike (astma e shkakuar nga alergjitë) zbuloi se ata që morën shtesë të përditshme të vajit të peshkut, për një muaj kishin nivele më të ulëta të leukotrieneve, kimikate që kontribuojnë në reagimin alergjik.
PËRDORNI DETERGJENTE ANTIALERGJIKE
Poleni dhe sporet mund të mblid-

hen në rrobat tuaja dhe është e rëndësishme që t'i eliminoni ato në mënyrë që të mos ndotni shtëpinë.. Ju mund të pastroni me detergjent normal ose përdorni një detergjent të veçantë antialergen. Hapi i fundit është që të thani rrobat tuaja në një tharëse.
SHMANGNI USHQIMET QË PËRMBAJNË BENZOATIN ADITIV MONOSODIUM
Një studim italian zbuloi se benzoata monozodiu shkaktoi simptoma të ngjashme me alergji, duke përfshirë rrufë, hundë të bllokuara, teshtitje dhe kruajtje, edhe të të rriturit që nuk vuajnë

nga alergjia. Kështu kini kujdes që mos konsumoni shumë turshi, ullinj, salca apo mbushje byreku, pasi ky përbërës gjendet te këto ushqime.
KONSUMONI LENG QERSHIE
Një nga opsionet më të shijshme për parandalimin e alergjisë është konsumimi i lëngut të qershisë pasi ky i fundit përmban një substancë të quajtur quercetin. Sipas Qendrës Mjekësore të Universitetit të Maryland, ushqimet që përmbajnë quercetin mund të ndihmojnë në uljen e simptomave të alergjisë.
PASTRONI KREVATIN ME UJË TË NXEHTË ÇDO JAVE

Kjo është mënyra më e mirë për të vradë gjallesat mikroskopike të bezdisshme që mund t'u shkaktojnë alergji. Edhe tapetat e qilimat mund të prishen dhe të bëhen baza të shkëlqyera të ushqyerjes për marimangat, mykun dhe kërpudhat. Rekomandohet që t'i lani mirë si dhe të pastroni orenditë nga pluhuri.
VENDOSNI NJË RAFT NË DERËN E PËRPARME
Nxitni familjen dhe mysafirët të heqin këpucët para se të hyjnë, në mënyrë që të zvogëloni sasinë e pluhurit, mykut dhe alergjenëve të tjera.
PËRDORNI SOLUCION ME UJË TË KRIPUR
Hidhni disa pika nga solucionin në hundë (i cili është ujë i kripur), kjo ndihmon në pastrimin në pjesën e sipërme të sistemit të frymëmarrjes tuaj dhe duke larguar alergjenët që shkaktojnë problemet. Kjo është shumë e lehtë për tu bërë dhe plotësisht natyrale: thjesht blijeni në farmaci solucionin me bazë kripe, ose mund ta bëni edhe vetë, pastaj përkuluni në lavaman dhe thithni pak nga solucionin, njëherë në njërën vrimë të hundës pastaj në tjetrën. Në fund lëreni që ajo të dalë përsëri jashtë. Këtë mund ta bëni një ose dy herë në ditë, kur ju mendoni se është e nevojshme.



Këshilla

Konsumoni lëngun e selinosë kundër artritit e tensionit të lartë

Lëngu i selinosë është jash tëzakonisht i shëndetshëm duke qenë një nga pijet më ushqyese për organizmin, pasi ekuilibron pehashin që është thelbësor për një shëndet maksimal. Gjethet e selinosë janë plot me vitaminë A, ndërkohë që kërcëjtë janë të mbushur me vitaminat B1, B2, B6 dhe C, por edhe me kalium, acid folik, kalcium, magnez, hekur, fosfor, sodium dhe aminoacide aq të nevojshme. Selinoja përmban shumë antioksidantë të fuqishëm që luftojnë inflamacionet në organizëm lëngu i kësaj bime është një alternativë e shkëlqyer për ata që vuajnë nga sëmundjet e shkaktuara nga inflamacioni siç është artriti. Lëngu i selinosë përmban vitaminë C dhe forcon imunitetin duke i dhënë organizmit forcën e nevojshme për t'u shëruar e mund të oksigjenojë organizmin në çdo anë të mundshme dhe të garantojë shëndetin e kockave. Studimet kanë treguar që pirja e lëngut të selinosë çdo ditë për një javë mund të ulë ndjeshëm tensionin e gjakut dhe qetëson



muskujt përreth arterieve, zgjeron enët e gjakut e ndihmon në qarkullimin e paqtë të tij. Lëngu i selinosë është një kurë e mrekulueshme natyrale për të ulur nivelet e kolesterolit. Lëngu që përfshihet nga dy kërcëjtë të selinosë mund ta ulë kolesterolin me të paktën 7 përqind. Minerale të vajrat esenciale të lëngut të selinosë kanë një efekt qetësues të sistemit nervor. Një aftësi e tillë e bën lëngun e selinosë mjaft terapeutik për ata që vuajnë nga pagjumësia. Duke pirë këtë lëng ata qetësohen dhe arrijnë të kenë

një gjumë të patrazuar. Lëngu i freskët i selinosë parandalon kalcifikimin ose krijimin e gurëve në veshka, tëmth dhe fshikëzën e urinës. Për më tepër, lëngu i selinosë ndihmon në eliminimin e toksinave dhe substancave të dëmshme apo gurët në këto organe. Kjo bimë ndihmon në luftimin e obezitetit. Hidhni një lugë çaji me mjaltë në një gotë me lëng selinoje dhe e pini përpara çdo vakti. Një gjë e tillë ju ndihmon të mos e teproni me ngrënie dhe të mbani nën fre dëshirat për ëmbëlsira.



Luftoni stresin e ankthin me bimën e vjeshtullës

Vjeshtulla, emri latin i së cilës është *Viscum Album*, është përdorur prej kohësh si bimë mjekësore. Sipas studimeve kjo bimë lufton spazmat, duke qetësuar dhe stimuluar sistemin imunitar. Ekstrakti i vjeshtullës përdoret tipikisht për të trajtuar kollën, azmën bronkiale dhe goditjet azmatike e madje në disa raste ka gjetur përdorim në trajtimin e epilepsisë, neurozës, hipertensionit arterial, ishemisë kardiake, lemezës dhe problemeve me tretjen. Kjo bimë është ideale për të qetësuar frymëmarrjen nga iritimet ose stresi si dhe kuron fytin e acaruar, kollën, inflamacionin bronkial. Ekstrakti i vjeshtullës merret në formën e tretësirës apo çajrave. Sugjerohet që ky ekstrakt të blihet patjetër në farmaci ose nga pika të licencuara të mjekësisë alternative. Një nga vlerat më të rëndësishme të vjeshtullës është ndikimi që ka në sistemin imunitar. Kjo është një nga arsytet përse kjo bimë është kaq e çmuar, sepse jo vetëm ngre në këmbë imunitetin, por edhe e mbron atë nga sëmundjet e jashtme. Vjeshtulla lufton bakteret, virozat dhe ka shumë antioksidantë që e transformojnë atë në mburojë perfekte për trupin ndaj sëmundjeve. Gjithashtu, nëse vuani nga ankthi, tiku nervor, gjumi jo i qetë, dridhjet, simptoma të tjera mendore ose fizike, kjo bimë shërben si një tonik gjithëpërfshirës për nervat. Për qindra vite me radhë, tretësirat e vjeshtullës janë këshilluar për t'u përdorur për ta trajtuar trupin nga jashtë dhe nga brenda. Dhimbjet e reumatizmit mund të trajtohen me tretësirën e kësaj bime. Nëse e konsumoni atëherë do të ndihmoni tretjen dhe zgjidhni problemet gastrointestinale.

Ornela Manjani

ATP: Dosjet e vitit 1996, pronarët që kompensohen

Ish-pronarët, aplikimet e ezauruara

Agjencia e Trajtit të Pronave publikon listën me 4900 pronarë, të cilëve u është njohur e drejta për kompensim. Dosjet i përkasin vitit 1996. Lista me vlerësimin përfundimtar për subjekte është botuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Trajtit të Pronave. Lista përmban të dhëna lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, mangësitë në dokumentacion apo vlerësimin përkatës jepen të detajuara në regjistrin që shqëron këtë njoftim. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit si dhe vlerësimin financiar për çdo dosje.

KOMPENSIMI FINANCIAR

Bazuar në skemën që po ndjek qeveria në zbatim të ligjit të ri për pronat, prioritet do të ketë prona truall, përkundër tokave bujqësore, që do të jepen për kompensim fizik. Pas shqyrtimit të

kërkesave, kompensimi financiar bëhet vetëm për ato subjekte, vendimi i të cilëve është përfundimtar, i ekzekutueshëm ose për kërkesat që nuk janë trajtuar asnjëherë për kompensim. Të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall, do të përfitojnë kompensim financiar nga fondi i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë. Ndërkohë, pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar do të kompensohet fizikisht nga fondi i tokës. Në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar rezulton se pjesa e mbetur është deri në 5 për qind më



e madhe se vlera 50 milionë lekë, atëherë subjekti kompensohet për të gjithë vlerën, në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar rezulton se pjesa e mbetur është më e madhe se 5 për qind mbi vlerën 50 milionë lekë, atëherë subjekti përiferencën mbi 50 milionë lekë, kompensohet fizikisht, nga fondi i tokës.

KOMPENSIMI FIZIK

Agjencia e Pronës ka në zotërim 23 mijë hektarë tokë bujqësore, për të cilat ka përfunduar më herët edhe vlerësimi ekonomik, të cilat do të përdoren për skemën e kompensimit fizik. Për ndarjen e kësaj sipërfaqjeje, dy do të jenë kriteret bazë. Kriteri i parë është rendi kronologjik i vendimeve, që do të thotë se, sikurse kompensimi financiar, edhe ky kompensim do të fillojë me vendimet më të vjetra në kohë. Kriteri i dytë lidhet me vendndodhjen e pronës që do të përfitojnë si kompensim fizik. Pra, pronari do të kompensohet me një pronë nga fondi

fizik, e cila gjeografikisht është më afër me pronën që i është njohur për kompensim. Në lidhje me dokumentet që duhet të depozitohen, ato nuk ndryshojnë, por mbeten të njëjta, si në rastin e kompensimit financiar. Ndryshon vetëm formulari i aplikimit, i cili është specifik për secilin rast. Në total janë 26 mijë vendime të formës së prerë, të cilat presin të kompensohen. Bazuar në ligjin e ri, Agjencia e Trajtit të Pronave ka nisur një proces të ri rivlerësimi, ku një metër katror tokë do të llogaritet me çmimet e tregut, por zëri kadastral nuk do të jetë ky i sotmi, por ai që ka pasur prona në çastin e shpronësimit.

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	----------------------------	-----------

(Vijon nga numri i djeshëm)

Lezhë	Nikolin Vlasi			
Lezhë	Ndue Gjin Ndoka			
Elbasan	ALI ZENEJA			3,264,482
Shkodër	Ruzhdi Duli			
Shkodër	Hasiqe Dibra			2,468,190
Tiranë	JONUS HOXHA			-
Tiranë	AGIM KOKONOZI			
Tiranë	BESIM ZANA			10,278,108
Tiranë	XHEVDET KUMBARCE			16,742,250
Tiranë	ISMAIL AGALLIU			19,688,886
Fier				9,489,248
Gjirokastër	Mevlan Lico Serjani			331,921
Gjirokastër	Myftar Haxhia			172,107
Korçë	Idriz Isaku			47,190
Kukës	Hamit Bajraktari			210,970
Kukës	Qamil Nerguti			554,058
Kukës	Enver Taci			550,028
Kukës	Rasim Isuf Pashku			11,872
Kukës	Kujtim Duraku			-
Shkodër	Beqir Lac Lacaj			
Tiranë	CLIRIMTAR KAZAZI			11,103,915
Tiranë	VASIL FINDIKU			1,875,132
Tiranë	HYSEN QATIPI			
Tiranë	BESIM MUZHAQI			3,750,264
Tiranë	JORGJI TERCA			24,108,840
Durrës	Skënder Hoxha			-
Durrës	Mereme Tivari			
Durrës	Irfan Brinja			
Durrës	Stefan Lajpa			
Durrës	Mihal Kisi			
Durrës	Alma Kraja			
Durrës	Eugen Korreta			3,329,028
Korçë	Muazes Kadilli, Radije Kadilli			624,582
Durrës	Vangjel Anastasiadhi			5,497,485

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	----------------------------	-----------

Korçë	SANDRI MILE			495,680
Kukës	Ibrahim Jeminaj			
Kukës	Haxhi Asllani			
Kukës	Ramadan Lusha			
Kukës	Zhuje Ali Metaliaj			
Kukës	Bajram Metaliaj			
Kukës	Feta Sakajani			
Kukës	Isuf Mus Muca			
Shkodër	Lutfi Sokoli			14,863,168
Tiranë	ALI QORALIU			-
Korçë	Themistokli Marko			
Dibër	Kapllan Keçi			
Korçë	Shefki Gora			34,400
Korçë				
Dibër	ISLAM NDREU			
Dibër	FRROK PRENG TOSKU			
Dibër	ADEM BIBA			
Dibër	PETRIT BIBA			
Dibër	ELEZ NDREU			
Dibër	Zenel Spahiu			
Dibër	SALI BUSHI			
Lezhë	Mark Ndrej Gjoka			
Vlorë	Fadil Rumani			387,200
Vlorë	Vasil Shameti			EZAURUAR
Vlorë	Thanas Fotini			EZAURUAR
Dibër	Shaqir Palamani			
Vlorë	Shaqire Shero			9,000
Vlorë	Vangjel Nino			
Elbasan	Hajrie Riza Shengjergji			702,020
Elbasan	LUFTI BRAHIMI			7,785,266
Elbasan	SHEQERE DERMYSHI			-
Elbasan	NEVRUS RIKA			1,211,887
Elbasan	AGIM KALA			
Elbasan	IBRAHIM MEMA			
Elbasan	SELAJDIN FACIA			1,201,680
Elbasan	HAXHI FACE			713,808
Elbasan	BAJRAM HIDRI			
Gjirokastër	Hekuran Bieta			596,996

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	----------------------------	-----------

Shkodër	Ramadan Kukaj			
Durrës	Kostandina Doniska			
Durrës	Gazmend Kodra			
Elbasan	KAMBER TAFANI			17,760
Elbasan	HYSEN KOTHERJA			EZAURUAR
Elbasan	RITVAN KANA			EZAURUAR
Elbasan	MAHMUT STAMBOLLXHIU			1,708,250
Kukës	Hysen Kastrati			
Kukës	Sejdi Kastrati			
Elbasan	PETRIT GORDURI			2,305,350
Fier	Shahin Majaçi			3,965,600
Fier	Llambi Bare			1,076,562
Fier				
Fier	Mina Bare			3,489,728
Fier	Artur Bare			
Fier				6,424,272
Fier	Qani Sulejmani			8,581,558
Fier	Hedije Baxhia			9,676,064
Fier	Etëm Arapaj			9,213,576
Fier	Lili Xhako			4,441,472
Gjirokastër	Shyqyri Xhaferaj			625,697
Kukës	Kadri Koka			
Kukës	Zenel Koka			
Kukës	Gezim Metaliaj			
Kukës	Selman Metaliaj			
Kukës	Besim Metaliaj			
Shkodër	Osman Mehmeti			
Shkodër	Berhan Cuciqi			
Shkodër	Belkize Shehi			-
Shkodër	Bajram Cuciqi			EZAURUAR
Shkodër	Qamil Bushati			63,131,795
Tiranë	JORGJI ADHAMI			7,969,311
Vlorë	Spiro Bituni			
Fier	Trifon Gjoni			-
Fier	Seri Resuli			7,982,753
Kukës	Hazir Meshi			
Tiranë	SHERIF BICI			6,295,086
Gjirokastër	Agron Vishe			

Kukës	Beqir Thaqi		
Kukës	Jahir Thaqi		
Kukës	Ismail Thaqi		671,821
Kukës	Qazim Lisha		
Kukës	Rrustem Meshi		
Kukës	Azem Lala		252,152
Kukës	Hasan Neza		
Kukës	Ramadan Tobli		
Lezhë	Preng Çup Kola		
Shkodër	Zenel Ibrahim Micojani		235,950
Shkodër	Nush Lush Gocaj		793,120
Shkodër	Kastriot Gera		
Shkodër	Fabri Masar BUSHATI		1,412,826
Shkodër	Minë Juka		17,958,210
Shkodër	Mehdi Gera		
Shkodër	Luan Causholli		
Shkodër	Alfons Coha		
Tiranë			
Tiranë	LUTFI KAJA		1,106,756
Tiranë	Elvira Semini, Maria Semini, Petrit Semini, Robert Semini, Valen		
Tiranë	KUSHI, XHAVVAIRE, FERID DEDA	EZAURUAR	
Tiranë	Aslan Bushati, Bedrije Bushati, Elvira Bush		808,710
Tiranë	Leme Kasa		7,270,571
Tiranë	ISUF, ZENEPE QEROSI, ETJ	EZAURUAR	
Tiranë	ZYBEJTE ÇAKA		42,239,357
Korçë	Zhazo Adranji		
Tiranë	Hajrije Hoxha, Kimete Hoxha, Kujtim Hox	EZAURUAR	
Dibër	Qamil Hajdari		
Korçë	Xhevat Berberi, Zabire Berberi, Zana Berber		365,485
Korçë	Saberke Zeqollari		45,654
Korçë	Keshille Lashtari		
Korçë	Hysen Kacupi		
Elbasan	LIRI DELIMETA		-
Elbasan	FATIME BICI		204,224
Korçë	Vasil Madhi		
Korçë	Skender Belishta		199,000
Korçë	Ibrahim Osmani		87,120
Korçë	Dhionis Nano		130,000
Korçë	Xhezmi Bardhollari		
Korçë	Dhimitra Foto		111,500
Korçë	Bukurie Vëllazëria		EZAURUAR
Korçë	Bardhyl Kocibelli		
Korçë	Hodo Myftaraga		
Korçë	Nasibi Agolli		
Korçë	Medi Lilollari		
Korçë	Asip Xhuti		269,000
Korçë	Agron Gjata		
Kukës	Ibrahim dhe Bajram Sheta		EZAURUAR
Tiranë	MUSTAFA MENERI		53,931,816
Vlorë	Dilaver Osmani		317,400
Korçë	Vasil Madhi		
Tiranë	SULEJMAN KARAJ		5,156,613
Tiranë	NAXHJE KARAJ		2,143,008
Tiranë	VAJE BRARI		48,351,618
Korçë	Petro Jorgolli, Tatjana Jorgolli		76,800
Korçë	Niazi Blacëri		2,302,197
Korçë	Pandi Sandi Petre		
Korçë			
Tiranë	NEXHMIJE SALIU		
Tiranë	REXHEP RAMOLLARI		
Korçë	Avni Dervishi, Feti Dervishi, Raif Dervishi, S	EZAURUAR	
Gjirokastrë	Kristo Nushi		EZAURUAR
Korçë			76,274
Korçë	Natasha Cepa		612,808
Korçë	Viktori Stojollari		637,434
Korçë	Ahmet Baçelli		232,697
Korçë	Nigjar Hoxha		661,042
Korçë	Servet Seferi		952,881
Korçë	Kristaq Thanas Demirazi		450,000
Korçë	Arben Sino		
Tiranë	ESAT XHEPA		
Durrës	Qerime Vrapit		19,978,665
Durrës	Fadil Metalla		

Gjirokastrë	Jorgo Arseni		
Lezhë	Luigj Miri		
Lezhë	Gjon Mhilli		
Tiranë	DYLEJMAN SALLAJ		15,155,000
Tiranë	OSMAN KAZAZI		EZAURUAR
Tiranë	SHEFQET MEZINI		
Tiranë	HYSEN HOXHA		EZAURUAR
Tiranë	BEDRI CASLLI		2,611,791
Tiranë	BASHKIM PELLUMBI		5,938,535
Vlorë	Bektash Shori		121,968
Vlorë	Esat Izeti		
Vlorë	Dhimiter Peta		7,040
Kukës	Sadik Gaxha		
Kukës	Zade Dajci		
Kukës	Rustem Neza		
Tiranë	BASHKIM BEKTESHI		
Tiranë	REMZLJE LAMI (XHAHYSA)		
Durrës	Vasil Rrufa		12,834,656
Durrës	Stavri Coka		-
Tiranë	Selman Pinar		EZAURUAR
Fier	Zhaneta Goxhabashi		
Durrës	Spiro Kaceli		
Elbasan	JETMIR BALASHI		4,701,104
Elbasan	HASAN DELIMETA		751,630
Elbasan	TRASHEGIMTARET		8,756,104
Elbasan	NAXHJE GJORGA		802,185
Elbasan	KUJTIM METRO		3,894,810
Elbasan	ISMAIL SALI ALLA		
Elbasan	ALI BAJRAM BOGDANI		2,551,182
Gjirokastrë	Muhedin Resuli		
Korçë	Lida Malolli		
Lezhë	Pjeter Ndue Pjetri		
Lezhë	Pjeter Mark Leka		
Tiranë	EDIP PUSTINA		60,941,790
Tiranë	LLAMBI E THANAS SHUNDI		3,549,357
Tiranë	SANLJE TAGANI		EZAURUAR
Tiranë	FRANKLIN NALLBANI		179,276,013
Vlorë	Isuf Cocoli		EZAURUAR
Vlorë	Riza Çoçoli		EZAURUAR
Lezhë	Kol Llesh Koka		
Vlorë	Andrea Jakubini		
Elbasan	FIQIRI KARINA		
Elbasan	SHAQIR NEBIU		
Shkodër	Latif Emin Kalaja		
Shkodër	Ndrek Gjinaj		3,874,240
Elbasan	SABIRE ALLKO		669,469
Korçë	Pellumb Skenderi		
Shkodër	Angeljin Daberdaku		2,481,269
Durrës	Qazim Xhakoni		
Durrës	Shpetim Kodra		
Korçë	Nuri (Nuredin) Hysi		EZAURUAR
Kukës	Nazif Asllani		
Kukës	Azem Halit Morina		
Lezhë	Mynyr Lezha		
Tiranë	BRIXHILDA DE MISTURA,(DOÇI)		
Tiranë	EVGENIJA KOTE		22,317,675
Berat	Selman Xhamallate		774,848
Berat	Nazif Xhamëni		
Berat	Jashar Satka		764,000
Gjirokastrë	Koco Kaliva		EZAURUAR
Gjirokastrë	Islam Myfit Matushi		EZAURUAR
Gjirokastrë	Abaz Cam		EZAURUAR
Gjirokastrë	Ksenofon Duka		EZAURUAR
Korçë	Thimi Subashi		1,632,600
Korçë	Minir Prisoj		71,230
Korçë	Petri Thimo		
Korçë	Hajdin Rusi		283,200
Korçë	Bido Luarasi		390,000
Korçë	Jetmir Hunçi		276,872
Korçë	Dhorke Shore		773,500
Korçë			
Korçë	Sulejman Kadriu		
Korçë	Kostandina Robo		
Korçë	Kike Mankolli		

Korçë	Kesmete Begolli		400,000
Elbasan	MEHMET BAXHAKU		2,459,880
Elbasan	Elizabeta Toptani		
Elbasan	ENVER GURMANI		1,659,320
Elbasan	HYSEN TAHIR XHANI		2,147,370
Elbasan	SEMLJE, HEDLJE BICAKU		22,166,400
Gjirokastrë	Jorgji Saqellari		
Gjirokastrë	Thoma Goxhabashi		
Gjirokastrë	Vangjel Saqellari		
Korçë	Shefki Selmani		405,778
Korçë	Paskal Namushi		2,668,623
Korçë	Drta Dakli		2,824,234
Korçë	Kasem Shkurti		3,268,890
Durrës	Ramazan Smoqi		-
Durrës	Ruzhdi Qesja		19,224,000
Durrës	Qamil Qesja		
Durrës	Qamil Qesja		
Durrës	Kristaq Rexha		
Durrës	Haxhi Qesja		
Tiranë	BAJRAM HOXHA		1,227,968
Tiranë	HAMIT MUÇA		9,856,000
Tiranë	NEXHAT LLAGAMI		
Tiranë	ERVIN LLAGAMI		
Tiranë	ISMAIL QAMETI (QIMETI)		19,688,886
Tiranë	ERNEST KAZANXHI		EZAURUAR
Tiranë	SUZANA BICAKU		
Tiranë	VASHLIKA PETRELA		
Tiranë	JONUZ SHIJAKU		52,369,758
Vlorë	Burhan Xhaxhiu		EZAURUAR
Vlorë	Vesel Ahmeti		263,200
Vlorë	Haxhi Karafil		470,000
Vlorë	Illa Telo		-
Shkodër	Kisha Abat Theth		
Korçë	Ollga Qano		
Shkodër	Luigj dhe Liza Gejci		3,874,240
Berat	Nebi Polovina		
Korçë	ALI JAJOLLI		
Lezhë	Islam Aliu		
Shkodër	Agron Zaganjori		
Shkodër	Bamir Bala		EZAURUAR
Tiranë	JORGJIA BACKA		6,564,380
Lezhë	Pashk Meta		-
Elbasan	RAZIE FUSHA		1,239,757
Elbasan	SULEJMAN HYSA		2,852,990
Elbasan	Gezim Cekrezi		1,596,187
Elbasan	Fadil Cekrezi		2,324,544
Elbasan	SALI SHULI		
Elbasan	DEMIRE BEGA		650,872
Elbasan	SHAQIR BEGA		1,146,775
Elbasan	MURAT OSMANI		
Elbasan	RAZIM ZADIA		1,772,174
Elbasan	ZYLAL DERVISHI		
Elbasan	BEKIM AHMETLLARI		
Fier	Baftiar Sufica		8,252,131
Korçë	Nigjare Qeska		
Korçë	Hysen Çokshiri		EZAURUAR
Korçë	Hysen Çakshiri		EZAURUAR
Korçë	THEMI NAQO		
Korçë	Petraq Pendavinji		
Korçë	Ilir Xhimanka		
Korçë	Bylyvare Goxhaj		EZAURUAR
Korçë	Spiro Lubonja		
Korçë	Stavri Kozari		
Korçë	Kostaq Mele		
Tiranë			
Tiranë	MEHMET DOMA		EZAURUAR
Tiranë	HAJDAR DOMA		3,301,879
Durrës	Mereme Lama		857,176
Durrës			165,624
Durrës			377,738
Durrës			1,383,208
Durrës	Qazim Masti		
Fier	Myqerem Pashaj		1,162,272

Opinioni i Ditës

Demonstrata e 26 marsit 1990 në Kavajë, ngjarje që meriton mirënjohje

Nga Xhevat MUSTAFA

(Vijon nga faqja 1)

...e 1990 në Kavajë" si dhe të Gëzim Çelhykës, organizatorë dhe pjesëmarrës aktivë në këtë demonstratë e përgjithshme në lëvizjen kundër diktaturës dhe për demokraci në Kavajë.

28 VJET MË PARË...

Rexhep Rrugeja: "...Më 25 mars 1990 zhvillohet ndeshja midis "Besës" dhe "Partizanit". Sipas vendimit, që ishte marrë 10 ditë më parë, çdo i ri demokrat, do të mbante me vete veprat e Enver Hoxhës dhe mjete mbrojtjeje. Po sipas vendimit, në minutën e 80 të gjithë tifozët në stadium do ngriheshin në këmbë me sinjalin e parë. Dhe me të vërtetë, i tërë stadiumi, me mijëra qytetarë, u ngritën në këmbë, duke grisur veprat e Enver Hoxhës publikisht. Pastaj shpërthyen thirrjet: Poshtë komunizmit! Enver Hitler! Poshtë diktaturës! Liri Demokraci! I tërë populli këndoi në një kor të vetëm: "O djem rrëmbeni pushkët, ja vdekje ja liri, se mjaft në robëri!"

I riu Betim Misiri, çau kordonin e policisë dhe u fut në mesfushë, për të ngritur dhe mbajtur lart moralin. Ndërsa populli këndonte këngë patriotike, policia e veshur me skafandra, me armë zjarri, e ndihmuar nga oficerët e sigurimit, u sulmën me egërsi drejt demonstruesve.

Kryetari i Degës së Punëve të Brendshme urdhëroi edhe kameramanin e Televizionit që t'i ndihmonte për identifikimin e autorëve dhe organizatorëve. Për reprezalje dhe frikësim policia gjakosi dhe burgosi dhjetëra të rinj.

Si kundërpërgjigje të reprezaljeve të policisë dhe burgosjes së shokëve, të cilët u torturuan, qendrat drejtuese të demonstratës morën vendim unanimit që më 26 mars 1990 të bëjnë një demonstratë tepër e fuqishme. Sipas vendimit, bashkimi i demonstruesve do bëhej tek parku i qytetit të Kavajës, në orën 5 pasdite. Qazim Kariqi kishte lajmëruar Ndërmarrjen Elektrike, që në orën 7 të fikeshin dritat. Disa qindra të rinj u grumbulluan para godinës së policisë me thirrjet: Vrasës lironi shokët tanë! Aty dëgjoheshin edhe thirrjet vajtuese të nënave dhe motrave të djemve të Kavajës, që protestonin për bijtë e tyre. Të rinjtë goditën me gurë policinë, sulmuan godinën dhe makinave përrethiu vu zjarri. Policia u struk nëpër bodrumë.

Pas 15 minutash demonstruesit shkuan tek Komiteti i Partisë, duke e vazhduar protestën e tyre edhe më me gjumë dhe vendosmëri.

Të ndarë në disa grupe, krahshtërnguar, ata manifestuan nëpër qytet me parulla kundër komunizmit. Çaste më emocionë të jashtëzakonshme! Të bëhej zemra mal tek shihje këto djelmoshë krahshtërnguar, që për liri dhe demokraci, po rrezikonin edhe jetën e tyre rinore. Sërish populli u bashkua me demonstruesit.

Me 27 dhe 28 mars 1990, Sigurimi i Shtetit arrestoi dhjetëra të rinj dhe i torturoi në polici. Tortura të tmerrshme poluan Fatmir Veliu, Qazim Kariqi, Vasil Duro, Jak Shtini, Xhevat Hyllviu, Tahir Okshturni, Rexhep dhe Ilir Rrugeja, etj, të cilët i dërguan në hetuesinë e Durrësit. Sërish natën e 28 marsit e deri në mëngjes, qindra gra, vajza, prindër të familjeve

...Atyre që bënë demonstratën e 26 marsit 1990 në Kavajë, të gjithë shqiptarëve që kishin dhe kanë ëndërr dhe dëshirë zemre demokracinë e vërtetë dhe Shqipërinë europianoperëndimore, të përafërt me Zvicrën, nuk u mbetet alternativë tjetër, veçse të mendojnë për 26 marse të tjerë, për një PD tjetër, për një PS tjetër, për një Demokraci tjetër, për një Shqipëri tjetër...



të arrestuara dhe banorë të tjerë të qytetit protestuan tërë natën para Degës së Punëve të Brendshme. Britmat e nënave dhe vajzave me të qararë e tyre dëgjoheshin shumë larg. Nga plot zëra u dëgjuan edhe thirrjet: "Kriminelë, ju ka ardhur fundi. Lironi fëmijët tanë!"

Në Durrës, bazuar në thënie të të rinjve demokratë të burgosur, i torturojnë, duke përdorur edhe pistoletën elektrike. I lejné pa bukë, pa gjumë, duke u kërkuar me çdo kusht organizatorët. Xhelatët e kuq, kur e panë se as torturat fizike dhe psikike nuk i nënshtruan të rinjtë demokratë, i dënojnë me burgime me aktakuzën: "Agjitacion e propagandë, përmbyse e pushtetit me dhunë, dhunim me forcë i Degës së Punës së Brendshme dhe i Komitetit të partisë". Vuajtjet e këtyre të rinjve qenë edhe më të tmerrshme. Disa prej tyre u liruan prej burgjeve në prag të fitores së Demokracisë më 22 mars 1992. Lajmet që përhapeshin për Kavajën dhe shprehjet "ç'po bën Kavaja", "presim nga Kavaja" ishin shumë domethënëse...

Gëzim Çelhyka: "...Demonstrata e 26 marsit u udhëhoq nga trimat Qazim Kariqi, Tahir Okshturni, Dik Ejuji, Idriz Kazazi, Xhevat Hyllviu, Jak Shtini, Nik Gjoni, Art Pagra, Arjan Musaj dhe plot të tjerë, që meritojnë një obelisk nderi e lavdie, ku t'u shkruhen të gjithëve emrat me germa të arta. Nga të gjitha lagjet e Kavajës, mendoj rreth 200 veta, guxuan dhe marshuan drejt policisë në revoltën e paparë në historinë e diktaturës. Demonstruan pa u frikësuar nga forcat dhe armët e shumta të policisë dhe atyre speciale dhe i dhanë të gjithë Shqipërisë mesazhin se kishte ardhur koha që ky regjim duhej shembur: Kam banat që gjëman fort dhe gjatë në Kavajë më 25 e 26 mars ishin prelude i lirisë dhe demokracisë. Në arshivat sekrete të prokurorisë e të ministrisë së punëve të brendshme protesta e 26 marsit përshkruhet: "...Nga analiza e të gjitha të dhënave arrijmë në përfundim se ngjarja është rrjedhojë e një pune armiqësore të organizuar... Prandaj, qysh të nesërmen erdhën në Kavajë urgjentisht nga Tirana drejtues të lartë të Partisë së Punës dhe të qeverisë së saj. Mes tyre edhe zëvendës ministri i punëve të brendshme, Zylyftar Ramizi..."

PAS 28 VJETËVE...

Tani pas 28 vitesh, organizatorët dhe pjesëmarrësit e kësaj demonstrate, si dhe shumica e popullit të Kavajës, që i mbështeti me zemër, me siguri, krahas respektit, mirënjohjes, krenarisë ndiejnë edhe zhgënjim e keqardhje. Dëshira dhe sakrificat e tyre për Demokraci të vërtetë, për Shqipëri të standardeve të përparura europiane në zhvillimin ekonomik-social, në treguesit e punësimi, pagave, pensione, të mirëqenies, të përgjithësi, mund të thuhet se nuk dhanë frytë e pritura. Ato u keqërdorën dhe u shfrytëzuan ose nga kundërshtarët e tyre më 25 e 26 mars dhe 10 korrik 1990, më 22 mars 1992, ose nga njerëz, që bënë spektatorin apo që kishin kontribuar fare pak për shembjen e komunizmit dhe fitoren e demokracisë. Aktualisht në majën e piramidës politike dhe qeverisëse në Shqipëri janë bij e bija, nipër e mbesa, dhëndurë e nuse të figurave kryesore të ish-diktaturës emveriane apo ramiziane. Mjafton të kujtohet se Edi Rama, nipi i Spiro Kolekës, është prej më shumë se 4 vjetësh kryeministër i Shqipërisë, se djali i Sulejman Bushatit është ministër i Jashtëm, se Gramoz Ruci është kryetar i parlamentit, Fatmir Xhafaj ministër i Brendshëm...

Tani pas 28 vjetësh mund të kuptohet edhe më mirë se si janë shpërblyer Kavaja dhe Shkodra, si arenat e para të kundërvënies masive ndaj diktaturës komuniste dhe për kontributin historik të tyre për fitoren e demokracisë. Jo rastësisht, por nënkuptueshëm për hakmarrje, këto dy qytete kanë nivel më të larta të papunësisë e të varfërisë. Duke i referuar faktit se Shkodra përjeton çdo vit edhe përm-

bytje masive nga shirat, nga Buna dhe hapja e urdhëruar e portave në digën e Liqenit të Vaut të Dejës, mund të mendohet se urrejtja dhe hakmarrja ndaj Shkodrës janë edhe më të forta. Gjithsesi, mesazhi që u jepet nga lart, nga politika dhe nga pushtetarët, kavasjeve dhe shkodranëve, është lehtësisht i kuptueshëm: "Dëshetë demokraci, ja kjo është demokracia që meritojnë! Vuani tani!"

Sidomos gjatë periudhave të qeverisjes nga e majta, meritat dhe kontributi për rrezimin e komunizmit dhe fitoren e demokracisë, në vitet 1990-1992, nderimi si "Pishtar i demokracisë" dhe si themelues apo militant i PD-së, për plot prej këtyre ka sjellë më shumë të këqija se sa të mira. Përmbledhur shkurt fare: harrësë, mosmirënjohje, papunësi...Kjo mund të interpretohet edhe si persekutim politik në një formë të re, pak më të butë. Por, duke u thelluar në analizë, mund të dalë edhe mesazhi tjetër kërcënues, me adresë nga e majta: "Bëhuni rilindas, hidhni në koshin e plehrave teserat e PD-së, dëshmitë dhe dekoratat e "Pishtarit të Demokracisë". Përndryshe, e merrni me mend se çfarë ju pret!". Po kaq trashë fshihet edhe mesazhi tjetër: kështu "Rilindja" jonë bëhet edhe më e plotmbështetshme, e plotpushtetshme, e par-zveshme, si partia e Putinit në Rusi, si partia e Erdoganit në Turqi..."

Nga ana tjetër, PD-ja është shumë larg vetvetes së Dhjetorit 1990 e të 22 Marsit 1992 dhe shpresave e pritshmërive ndaj saj. Edhe katandisja e PD-së në këtë gjendje mjerane, sa të dëgjohet masivisht shprehja e fabrikuar dhe raticion-varrosëse se "të dy palët janë njësoj", si motra binjake dhe rikthimi i Berishës, nuk është e rastësishme. Natyrisht nuk ishte as e pashmangshme. Merrret me mend se është investuar pak kursim dhe është punuar me zgjuarsishtë e vazhdimësi për ta rënur e për ta marrë kalanë e saj nga brenda. Ky investim është bërë edhe nga brenda vetë PD-së, nëpërmjet "kuajve të Trojës" apo "mishrave të huaja" të futur me shumicë gjatë fushatave të ripërtëritjes, me firmën apo nën hundën e Berishës e të Luzlim Bashës. Plot prej këtyre, edhe me pseudonime të vjetra, u mbështetën dhe arritën të bëhen drejtues të lartë, ministër, deputetë, kryebashkiakë, zyrtarë të të gjitha niveleve... U pa dhe kuptua shpejt, por nuk u reaguua me kohë dhe vendosmërisht për t'i flakur si misionarë apo dënuar si të korrupuar e të interesuar kryesisht për përfitimet e tyre vetiake, familjare e klanore...

Në këto kushte, atyre që bënë demonstratën e 26 marsit 1990 në Kavajë, të gjithë shqiptarëve që kishin dhe kanë ëndërr dhe dëshirë zemre demokracinë e vërtetë dhe Shqipërinë europianoperëndimore, të përafërt me Zvicrën, nuk u mbetet alternativë tjetër, veçse të mendojnë për 26 marse të tjerë, për një PD tjetër, për një PS tjetër, për një Demokraci tjetër, për një Shqipëri tjetër...

HOROSKOPI

DASHI
Sot duket një ditë shumë produktive. Marsi dhe Hëna do t'ju shtojnë entuziazmin dhe do të nxjerrin më në pah shpirtin tuaj luftarak dhe të lirë. Në këtë gjendje do të jeni kurajë për të forcur edhe lidhjen tuaj, që është shumë e rëndësishme për ju.

DEMI
Do jeni ju që do t'i përcaktoni detyrat vetes suaj në punë, sepse më mirë se ju, askush nuk mund ta bëjë. Një frymë e re do të ndryshojë të gjithë rutinën. Rritja e dukshme e financave do ju bëjë të ndjeheni akoma më mirë.

BINJAKET
Një çështje profesionale ju prish marrëdhëniet me dikë shumë të afërt në punë. Anulimi i një udhëtimi do të jetë shkak i zhgënjimit tuaj. Kjo gjë do t'ju ndikojë disi edhe te financat, ndaj qëndrimi juaj do të jetë shumë i ftohtë. Nuk do jepni mundësi tjetër.

GAFORJA
Intuita e shënklyer që keni për të njohur njerëzit nuk do kalojë pa u vënë re nga eprorët tuaj. Qetësia dhe mënyra e pagabuar intuitive nuk do të lejojë të humbni asnjë marrëveshje të rëndësishme të këyre ditëve. Të njëjtin perkushtim do të keni edhe në marrëdhëniet me partnerin dhe gjithçka do shkojë siç doni ju. Besoni gjithnjë te vetja.

LUANI
Yjet në shenjë tuaj do ju bëjnë që të keni një ndikim të mirë në të gjitha aspektet personale dhe profesionale. Mundësi që nuk duhen neglizhuar do ju paraqiten dhe duhet të mendoni me logjikë dhe vëmendje. Mundësitë vijin papritur, ndaj mbajini sytë hapur në çdo moment.

VIrgJERESHA
Nëse i referoheni logjikës suaj për gjithçka, gabimet do jenë të pakta. Flisni me familjen për çdo gjë që ju shqetëson dhe aty do jeni shumë përgjigje që nuk ia jepni dot vetes. Për të kapërcyer momente të vështira ju duhen pranë njerëzit më të besuar, përfshirë këtu edhe partnerin.

PESHORJA
Do jepni gjithçka që gjërat rreth jush të jenë sa më të lumtura dhe të qeta. Keni kaluar disa vështirësi në punë dhe familje, por tani çdo gjë po kthehet në normalitet. Asnjëherë mos e humbni besimin që çdo gjë do të shkojë mirë. Gjendja e vështirë financiare po përmirësohet.

AKREPI
Sot do të mbani qëndrime të ashpër ndaj padrejtësisve. Po e ndjeni që nuk keni më forcë, por mos u dorëzoni. Jo gjithmonë gjërat shkojnë në rrugën e duhur. Ruani vendin tuaj dhe mos u ndikoni nga asgjë, tregoni qytetërinë dhe edukatën që ju karakterizojnë.

SHIGJETARI
Komunikimi, qetësia dhe udhëtimi do jetë kryefjala e ditës së sotme. Keni shumë projekte në mendje, por duhet të jeni edhe personat e duhur për t'i bësuar. Që një punë të arrijë sukseset e merituara, duhet të bëhet në grup. Mos e lini jashtë as partnerin tuaj.

BRICJAPI
Disa dëshime rrezikojnë që të mos ju lënë të flini i qetë. Por herët a vonë e vërteta del në shesh dhe më në fund do të jetë qetësia. Nëse doni t'i jepni fund të lidhjeve që nuk ju përmblus, mendojeni mirë, por më pas veproni.

UJORI
Hëna në shenjë tuaj është gjithmonë një burim i mirë i qetësisë dhe humorit. Pavarësisht lodhjes që keni, mbrëmja për ju do të jetë ndryshe se. Takime të ndryshme dhe jo vetëm do ju ndryshojnë rutinën e përditshme. Jepini vetes më shumë mundësi për të kaluar mirë në praninë e personave të zgjedhur.

PESHQIT
Sot nuk do të jetë një ditë e qetë, sepse do të keni një pozicionin disi armiqësor të sive në shenjë tuaj. Lirinë e veprimit do ta keni të kufizuar dhe disa marrëveshje mund t'ju shqetësojnë në pjesën më të madhe të ditës. Lajm i mirë për ju është që financat parashikohen të jenë në gjendje të kënaqshme.

Katovica

Emri sllav i Maqedonisë-tapi për pronësinë maqedonase

(vijon nga faqja 1)

Nga SHABAN MURATI

Emri sllav i Maqedonisë do të thotë se shqiptarët e Maqedonisë shpallen zyrtarisht se janë qiraxhinj në shtetin e Maqedonisë.



... për gjetjen e një emri, që fshin pjesën shqiptare të shtetit të Maqedonisë. Burime diplomatike bëjnë të ditur se gjatë vizitës së ministrit të Jashtëm grek, Nikos Kotzias, në Shkup në 22-23 mars, Athina dhe Shkupi më së fundi kanë rënë dakord për emrin sllav "Gorna Makedonija" dhe ky pritet të jetë propozimi i kompromisit, që dy kryeqytetet do t'i paraqesin ndërmjetësuesit të OKB, Metju Nimic, kur shefat e diplomacisë së dy shteteve do ta takojnë në Vjenë në 30 mars. Radio gjermane "Dojçe Welle" njoftonte në 22 mars se "Gorna Makedonija" është formula magjike e Athinës, që kërkon të zgjidh debatën 27 vjeçar midis Athinës dhe Shkupit".

Emri sllav i Maqedonisë si "Gorna Makedonija" përfaqëson një pazar të diplomacisë greke dhe maqedonase në dem të interesave të popullit shqiptar në Maqedoni. Duke i vënë emrin me fjalë maqedonase, në gjuhën maqedonase, të shkruar si një fjalë e vetme dhe të papërkthyer në gjuhët ndërkombëtare, siç ka kërkuar Athina, qeveria greke siguron qarqet e veta nacionaliste se shteti i Shkupit është vetëm sllav si brenda, ashtu dhe në arenën ndërkombëtare, dhe nuk paraqet rivendikim për Maqedoninë greke. Në të njëjtën kohë Athina i jep si shpërblim Shkupit tapinë mbi shtetin e Maqedonisë, i cili me këtë tapi të emrit sllav ligjëron pronësinë maqedonase të shtetit të Maqedonisë. Nga ana e vet Shkupi, duke pranuar formulën e diplomacisë greke për emrin sllav, realizon strategjinë e tij të vjetër që nga krijimi i shtetit në 1991, për fshirjen dhe mënjanimin zyrtar e ndërkombëtar të së drejtës së popullit shqiptar në Maqedoni për të qenë bashkëpronar dhe bashkëdrejtues i shtetit. Kryeministri maqedonas Zoran Zaev luajti bllofin duke bërë një gjysmë hapi me ligjin për avancimin e gjuhës shqipe, por pa i dhënë asaj statusin e gjuhës zyrtare në krah të territorin e shtetit njësoj si gjuha maqedonase, dhe tani vullos statusin e popullit shqiptar si popull i kategorisë së dytë. Emri sllav i Maqedonisë do të thotë se shqiptarët e Maqedonisë shpallen zyrtarisht se janë qiraxhinj në shtetin e Maqedonisë.

Athina, edhe Shkupi, po e trumbetojnë ndërkombëtarisht se zgjidhja e emrit është afër dhe siç tha Kotzias në 23 mars në Shkup "sot kemi rënë dakord në një shkallë të madhe". Kjo zgjidhje me emër sllav po gjen mbështetje edhe nga disa qarqe diplomatike ndërkombëtare. të cilat i kanë në

padurim të zgjidhet ky konflikt midis një shteti anëtar të BE dhe një shteti kandidat i BE, pavarësisht se kush e paguan koston brenda shtetit të Maqedonisë.

Në një situatë të tillë, ku e drejta e popullit shqiptar po bëhet kurban i radhës i diplomacisë greke dhe maqedonase, nuk është normale që partitë politike shqiptare në Maqedoni, si ato në qeveri, ashtu dhe ato jashtë saj, të rrinë e të vështrtojnë vjet dhe të mos ngrihen kundër të ashtuquajturës formulë magjike greke të emrit sllav. Në një korrespondencë me një nga intelektualët shqiptarë më në zë në Maqedoni lidhur me pesë opsionet e hedhura në tryezën diplomatike greko-maqedonase për emrin pas ardhjes së Zaevit në pushtet, në 14 shkurt i shkruaja se "Gorna Makedonija" është zgjidhja më negative.

Është përgjegjësi edhe e faktorit politik shqiptar në Maqedoni, nëse pranohet emri sllav për shtetin nga qeveria, ku bëjnë pjesë. Emri "Gorna Makedonija" është edhe më i keq se FYROM, sepse legalizon ndërtimin dhe funksionimin e paligjshëm të shtetit të Maqedonisë si shtet vetëm i popullit maqedonas. Nuk men-

doj se është e logjikshme dhe e pranueshme që faktori politik shqiptar të qëndrojë në qeveri, nëse qeveria pranon emrin sllav të shtetit. Qysh në vitin 2013 në një analizë timen për qëndrimin e shqiptarëve lidhur me emrin, kam shkruar se "emri është çështje e shtetit dhe shqiptarët, duke qenë pjesë e rëndësishme ekzistenciale e atij shteti, kanë të

Shqipëria duhet të shprehë me forcë kundër çdo emri sllav të Maqedonisë.

drejten dhe detyrën të jenë pjesë e vendimeve për zgjidhjen e tij". (Libri "Shqiptarët e Maqedonisë-prioriteti i çështjes shqiptare", viti 2016, fq. 216).

Është mendim i pranuar nga të gjithë se në parim zgjidhja e konfliktit të vjetër për emrin është një hap pozitiv, sepse i hap rrugën Maqedonisë për anëtarësim në BE dhe në NATO. Por këtu ka një hile nga diplomacia greke dhe maqedonase. Duke

ditur sensibilitetin e diplomacisë euroatlantike për zgjidhjen e kofliktit të bezdisshëm për emrin, Athina dhe Shkupi e drejtuan rrugën e zgjidhjes jo tek emrat gjithëpërfshirës, por tek emri sllav, i cili neutralizon interesat e popullit shqiptar në Maqedoni, si dhe interesat e kombit dhe të faktorit shqiptar në Ballkan.

Është një manovrim i dëmshëm diplomatik greko-maqedonas, që prek më gjerë edhe interesat e Shqipërisë dhe të Kosovës. Çështja e emrit sllav është rast që Shqipëria të prononcohet me forcë për qëndrimin në mbrojtje të interesave të popullit shqiptar në Maqedoni. Shqipëria duhet të shprehë me forcë kundër çdo emri sllav të Maqedonisë. Është e paktueshme përse diplomacia shqiptare gjatë gjithë këtyre dekadave nuk është pronicuar kurrë se për çfarë emri është dakord ajo. Ka qenë një naivitet qëndrimi i disa ministrave të Jashtëm të Shqipërisë, të cilët i përmbaheshin pikëpamjes se emri është çështje e maqedonase dhe e grekëve. Por emri i Maqedonisë është çështje edhe e popullit shqiptar në Maqedoni, i cili nuk mund të përjashtohet nga pronë-

sia e shtetit dhe nuk mund të pranohet që tapia t'i jepet vetëm popullit maqedonas. Nuk qëndron as pikëpamja se prononcimi për çështjen e emrit mund të quhet ndërrhyrje në punët e brendshme të Maqedonisë. Emri i shtetit, në një kohë që ai shtet ekziston nga demografia, nga ekuilibri dhe nga peshat si shtet i përbashkët i popullit maqedonas dhe shqiptar, nuk është dhe nuk mund të jetë çështje vetëm e maqedonasve.

Diplomacia shqiptare duhet të marrë shembull nga Bullgaria, e cila vazhdimisht ka bërë të ditur qëndrimin e saj zyrtar lidhur me emrin e Maqedonisë. Në 16 shkurt 2018 presidenti i Bullgarisë, Rumen Radev, deklaroi: "Pozicioni ynë është i qartë: zgjidhja e debatit për emrin nuk duhet të përmbajë ndonjë element gjeografik, i cili në vetvete aludon tek pjesë të territorit që i përket Bullgarisë". Paraardhësi i tij, presidenti Georgi Purvanov, që në vitin 2011 e ka parajamëruar Shkupin se për Bullgarinë emra gjeografikë si "Gorna Makedonija" apo "Severna Makedonija" janë të papranueshëm. Nuk kemi informacion se si do të veprojnë Bullgaria tani që emri "Gorna Makedonija" është një emër gjeografik, por nuk duhet haruar se Sofja e ka bërë të qartë se do të përdorë të drejtën e saj të vetos në BE dhe në NATO, nëse emri i ri shkollon ndesh me interesat bullgare.

Mendimi im është që diplomacia e Shqipërisë, ndonëse është vonë, duhet të shprehë zyrtarisht qëndrimin e saj kundërshtues ndaj një emërtimi sllav të shtetit të Maqedonisë. Duhet ta shprehë sa më parë, për të mbrojtur interesat e popullit shqiptar në Maqedoni dhe interesat e kombit shqiptar në Ballkan.

Euforia, që po frynëj diplomacia greke dhe maqedonase për zgjidhjen e emrit, nuk duhet të pengojë as Shqipërinë, as Kosovën dhe as faktorin politik shqiptar në rajon, që t'i kundërvihen ofensivave të sllavizimit të dhunshëm të rajonit dhe të mos lejojnë nëpërkëmbjen e interesave shqiptare në rajon. Kjo i duhet bërë prezente edhe faktorit ndërkombëtar, i cili duhet të kuptojë se emri sllav i Maqedonisë, që i jep tapinë maqedonase për shtetin, mund të mbyllë për kohësisht një plagë integriteti, por mund të krijojë plagë të tjera të nëndeshme në marrëdhëniet ndëretnike shqiptaro-maqedonase, të cilat mund të shpërthojnë në një të ardhme. Asnjë pretekst nuk mund të përligjë sanksionimin zyrtar të pabarazisë midis popujve brenda një shteti.

Sot në Elbasan luhet Shqipëri-Norvegji, pritët aktivizimi i disa prej elementëve të rinj

SULMUESI

Manaj: Golat e mi? Vetëm Mesi mund të vendosë një ndeshje!

Autori i dy golave në ndeshjen e fundit me Sllovakinë, sulmuesi Rei Manaj, ka dalë në konferencë shtypi bashkë me trajnerin Bushi. Ai është shprehur se skuadra kuqezi nuk bazohet tek individët, por të grupi, ndërkohe që shpreson për fitore në ndeshjen e Sllovakisë. "Në Sllovaki shkojmë për 3 pikë. Ishin shumë faktorë, që nuk na lejuan të fitonim ndeshjen e pak ditëve më parë. Fusha ishte e vështirë për të menaxhuar lojën dhe përqendrimi na mungoi. Nuk jam aty ku duhet dhe duhet të jap më të mirën time. Jam i kënaqur që jam tek ekipi U-21 dhe dy golat nuk mjaftojnë, pasi duhet ta fitonim ndeshjen. Shpresoj të marrim fitore atje. Nuk e di nëse do të kualifikoheshim, nëse do të luajmë shpesh me ekipin U-21. Mund të merrnim edhe më pak pikë, nëse do të luajmë unë. Trajneri dhe staffi teknik vendosin. Vetëm Mesi mund të vendosë ndeshjen dhe ne nuk kemi një Mesi në skuadër. Bare është punëtor dhe shpresoj të japë më të mirën të Kombëtarja. Te merkatoja e verës nuk mendoj asgjë deri tani, pasi kam ende kontratë me Interin", tha sulmuesi kuqezi.

Kristian Panuçi: Dua të fitoj, siç bëmë me Turqinë

Berisha i dëmtuar, në portë do luajë Strakosha

Jeton Selimi

Kristian Panuçi kërkoi të fitojë ndaj Norvegjisë, ndërsa këtë kërkoi ta bëjë me idetë që ka ai në kokë për fizionominë e skuadrës kuqezi. Me grupin që është paraqitur mirë në këto ditë stërvitjeje, trajnerit italian të Shqipërisë i duhet vetëm të zgjedhë titullarët si dhe të hartojë zëvendësimet për t'u dhënë minuta edhe prurjeve të reja në kombëtare. "Skuadra ka punuar mirë, ka punuar seriozisht. Jemi gati për Norvegjinë dhe duam ta mundim siç bëmë me Turqinë. Është e sigurt që për të ardhmen, kam një ide timen, edhe për ndeshjet e qershorit. Për sa i përket formacionit, kam dyshimet e mia. Kemi lojtarë si Roshi, që sapo ka nisur sezonin. Ka edhe nga ata që nuk kanë luajtur ende. Në sulm kam Balajn, Sadikun, Cikalleshin. Edhe për balotazhin Aliji-Lenjani do të vendos para ndeshjes", u shpreh Panuçi në konferencën e zakonshme për shtyp. Kërsëria është e madhe sidomos për lojtarët që ende nuk



TRAJNERI

"Skuadra ka punuar mirë, ka punuar seriozisht. Jemi gati për Norvegjinë dhe duam ta mundim siç bëmë me Turqinë. Është e sigurt që për të ardhmen, kam një ide timen, edhe për ndeshjet e qershorit. Për sa i përket formacionit, kam dyshimet e mia. Kemi lojtarë si Roshi, që sapo ka nisur sezonin. Ka edhe nga ata që nuk kanë luajtur ende. Në sulm kam Balajn, Sadikun, Cikalleshin. Edhe për balotazhin Aliji-Lenjani do të vendos para ndeshjes".

kanë zbritur ende në fushë me fanellën e Kombëtares dhe Panuçi jep përshtypjet e para për ta. "Ramadani ka stofin e një lojtari lider, ka

personalitet. Lojtarët e tjerë, unë kam 6 ndërrime në pozicion. Do të vlerësoj për zgjedhjet që do bëj. A do ketë minuta për Abazajn? Natyr-

isht që është një lojtar që 1 kundër 1 bën shumë mirë, por për të luajtur në ekipin kombëtar, duhet një stad më i lartë stërvitje. Do shohim.

Baren e kam ndjekur gjithmonë. Do të jetë pjesë e 26 lojtarëve që do të kem në konsideratë për eliminatorët e Europianit", tha trajneri italian në konferencë. Panuçi tregon se ndaj Norvegjisë do të luhet me skemën 4-3-3, ndërsa siguria e vetme sa i takon formacionit është porta, ku ai deklaroi se nga minuta e parë do të luajë Strakosha, pasi Berisha është i dëmtuar. "Për momentin po provojmë 4-3-3. Në fillim duhet të kem lojtarët. Tani po provojmë këtë modul, për të ardhmen ka edhe opsione të tjera. Natyrisht, nëse nuk sulmon, nuk fiton. Nëse do kishim këtë grup me Italinë, jam i sigurt që nuk do humbim. Kam bindjen, që kur kam marrë drejtimin, skuadra është ende më e fortë. Nuk do të qëndroj mbrapa, sepse kam edhe lojtarët për të sulmuar. Porta? Ndaj Norvegjisë do të luajë Strakosha. Berisha kishte një problem fizik dhe këtë e kisha vendosur. Kam folur me të dy portierët, një miqësore e luan Berisha, tjetër Strakosha. Në këtë pozicion, sforcohem shumë për të gabuar", theksoi ndër të tjera Kristian Panuçi.

Trajneri i Kombëtares U-21

Bushi: Sinani dhe Zhegrova nuk na hapnin as telefonin

Pas humbjes dramatike në "Selman Stërmasi" pak ditë më parë, ku skuadra e tij ishte dy herë në avantazh, trajneri i Kombëtares U-21, Alban Bushi, shpreson shumë për një reagim në Sllovaki. Do të jetë shumë e vështirë, pasi mungon edhe kapiteni Bare, i cili ka kaluar te Kombëtarja A, por Bushi e sheh me optimizëm ndeshjen e sllovakët. Ai ka folur edhe për Zhegrovën dhe Sinanin. "Lojtarët e njohin tashmë lojën e grupit dhe dhanë më të mirën. Lojën e kemi humbur për gabime individuale dhe jo kolektive. 2-3 lojtarë tanë janë më të mirë se ata individualisht. Kishim frikë për mbrojtjen, sepse e kemi pa minuta në këm-

bë dhe mbrojtja na dëmtoi. Lojtarët janë të motivuar dhe nuk duan motivim shitesë. Kemi pasur problem vetëm në repartin e mbrojtjes, sepse s'kanë luajtur mund të them. Dhe kështu i pësuam golat e dytë dhe të tretë, por jam i kënaqur me lojtarët. Vitin tjetër do të rriten dhe do të shohim një Shqipëri më të mirë. Ne luajmë ndeshjet kualifikuese dhe Kombëtarja luan miqësore. Kur trajneri na merr 3 lojtarë që na bënin punë, kjo do të thotë se ekipi U-21 ka cilësi. Mund të merrret edhe Manaj me sy mbyllur, pasi po bën më të mirën e mundshme me ekipin. Kemi shumë lojtarë të gatshëm për ekipin A. Mbrojtja është problematike. Këta mbrojtës janë më të mirët që kemi dhe vetëm



këto janë mundësitë e vetme që kishim. Shumë shpejt do të jetë edhe Kumbulla tek U-21. Ne shohim ku kemi probleme dhe duhet të shohim për mbrojtjes. Jemi ende në lojë matematikisht, por është e vështirë, pasi kemi 9 mungesa dhe 3 lojtarë te Kombëtarja A. Ismet Sinani dhe Zhegrova? Ne kemi bërë çdo gjë për të marrë lojtarë, por nuk mund t'i marrim me zor. Ata kanë thënë se do të vijin dhe në fund nuk të hapin telefonin", - ka thënë mes të tjerash trajneri Bushi.

Mesfushori vlerëson prurjet e reja në skuadër

Roshi: Krenar të jem kapiteni i Shqipërisë


Lojtari që do të mbajë lnesër shiritin e kapitenit të Kombëtares në miqësoren me Norvegjinë, Odise Roshi, u shpreh krenar për këtë detyrë, por gjithsesi ai qëndron me këmbë në tokë, teksa nuk kërkoi të shpërqendrohet dhe mban lart fokusin në takimin e nesërm. "Nuk jam i surprizuar, për mua është krenari të jem kapiteni. Këtu është vënë një rregull, kush ka më shumë ndeshje, do të jetë kapiteni i ekipit kombëtar. Për mua më shumë ka rëndësi ndeshja, por meqë jam kapiten, do jem modest, të eci akoma më para", deklaroi mesfushori i Akhmat Groznit në Rusi. Roshi është një nga ata lojtarë që pëson një transformim rreñfësor sa herë vesh fanellën kuqezi, teksa vetë lojtari rrefën se ndonëse jep gjithçka për klubin, është



tjetër gjë të luash për ngjyrat e kombit. "Është e vërtetë, impenjimi këtu është ndryshe. Luan me gjakun dhe për kombin tënd. Unë e vlerësoj në mënyrë maksimale. Jo se e nënvlerësoj klubin ku luaj, por këtu ka diçka ekstra", theksoi mesfushori fierak. Së fundmi në Kombëtare është shtuar shumë konkurrenca. Kapiteni u uron atyre mirëseardhjen dhe vlerëson aftësitë e rivalëve për një vend titullari, duke theksuar se kjo është diçka pozitive

për skuadrën. "Ne kemi shumë lojtarë me përvojë, por edhe elementë të rinj. Ka shumë konkurrencë, por për të mirën e grupit. Konkurrenca ecën përpara. Kemi bërë shumë seanca me intensitet të lartë dhe jemi fokusuar tek detyrat e trajnerit. I kam parë edhe në stërvitje Abazajn e Gavazajn, janë dy talente të mirë. Kanë kualitet të dy. Konkurrenca na bën shumë mirë, mua më bëjnë të stërvitem akoma më fort", përfundoi Odise Roshi.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Eshhtë babëzia.
8. Burton regjisor.
11. Skllavja e Abrahamit.
12. Një ditë në mbledhje.
14. Tyson i boksit.
15. Rrethojnë ringun.
17. Beson pa kufij.
19. Zola që shkroi Nana.
20. Eshhtë ankimum.
23. Pak elementarë.
24. Janë me para në bankë.
26. Matet pa kufij.
27. Janë ngrahina për reparte fabrikash.
28. Një zog i verdhë.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Qytet gjerman.
34. Një zonjë që ha gurë.
35. Pak analogji.

36. I ka plasur të paturpët.
37. Janë legjendat.
38. Nuk ka akoma një bebe.
39. Fillojnë mirë.
40. Janë brinjë në skuadër.
42. Shkrubet i shtati.
44. Nget edhe ajo e mirë
47. Mbahet në gisht.
48. Janë numrat 1, 3, 3...

VERTIKAL

1. Kanë shpatë të tilla.
2. Janë edhe ato polare.
3. Janë mizorët.
4. Janë male në Rusi të tilla
5. Eshhtë nusja me vello.
6. Një rreth pa ekstreme.
7. Mbyllin kuvendin.
8. Në kryr të titujve
9. Diku në qendër.
10. Markë cigaresh.
13. Janë rrefimet e të pandehurit.
14. Janë penjtë për gjergjef.
16. Mbarojnë fare.
18. Janë sitët e... provimëve.
20. Mund të jenë fotografikë të tillë.
21. Vitet pa kufij.
22. Një fjalë për tutje.
24. Brown i Kodit i Da Vinci-t.
25. Eshhtë e akuzuara... injorante
26. Baldwin aktor
27. Një pjesë e kandidatëve.
28. Krenar pa çift.
30. Grazia Cucinotta.
32. Paul këngëtar.
33. Janë pëshqjellat.
35. Inicialet e Moravia-s.
37. Pak makinacione.
38. Samuel bomber kamerunas.
40. Markë makine koreane.
41. Ente Kombëtare Durrës.
42. Fillojnë kurat.
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
45. Ekstreme në litar.
46. Fillojnë lejen.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

1. Satelit i Uranit.
6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
11. Tiran pa kufij
12. Në krye të armatës.
13. Një Ibrahim violinist.
14. Qendër ditore.
15. Mund të jenë fotografikë.
17. Inicialet e Einstein.
18. Një mbishkrim në kryq.
20. Janë si vite.
21. Thurman aktore.
22. Të parat në irritim.
23. I preu Seneka.
25. Fillojnë ilustrimet
26. Isaac Asimov.
27. Një Vladimir kompozitor.
28. Janë në modë.
30. Janë zyrat... qeveritare
32. Me të nxjerrin trarë.


35. Një shkop, thupër.
37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
39. U thyen në Salamina.
40. Një raport shumë i ngushtë.
41. Nota e diapzonit.
42. Fund heroi.
43. Një top në rrjetë.
45. Gjysma alarmi.
46. Herët pa zë.
47. Sampras i tenisit.
48. Me to bëjnë triko.
49. Një gjuajtje fluturimthi në tenis.
50. Janë kokrrat e lisit.

VERTIKAL


1. I famshëm ai i Sizifit.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Fillojnë rastësisht.
4. Një pjesë e napolitanëve.
5. Janë situatat e rrezikshme para portave.
6. Mund të jenë kundërajrore.
7. Lindin në kokë.
8. Gjysmë shtegu.
9. Hiden të parat.
10. Eshhtë njeriu i përsosur.
13. Një fjalë për tutje.
15. Fundi i një samurai.
16. Mbyllen me epilog.
17. Bel i maupassant.
19. Inicialet e Redford.
23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
24. Në hyrje të tokës.
26. Pak impresioniste.
27. Janë metrat në sipërfaqe
29. Hapet një për ajër.
30. Gjysmë krenar.
31. Një hidrokarbur.
33. Vrau Hektorn.
34. Një film i nxhruar.
36. Kupat pa kufij.
38. Inicialet e Nolte aktor.
41. Ullmann aktore.
43. Një brilantje moderne
44. Hotel pa kufij.
46. Ekstremë në hall.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	2	7						6	
1	3								
			4		5	1			
9				8					
		6	3		1	5			
				9					8
			1	8		2			
								2	9
5						7	3		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	2	8	6	9	1	7	3	4
6	9	4	7	2	3	8	5	1
1	7	3	4	8	5	2	9	6
7	5	9	1	6	8	3	4	2
8	6	1	3	4	2	9	7	5
3	4	2	5	7	9	6	1	8
4	8	6	9	5	7	1	2	3
9	3	5	2	1	6	4	8	7
2	1	7	8	3	4	5	6	9

Argëtim filozofik

- Bota është një anije mbi të cilën jemi të gjithë pasagjerë: nuk duhet të lejojmë që ajo të mbytet. (Mikhail Gorbaçov)
- A s'e sheh që luani rri i heshtur, por nga ai të gjithë janë të frikësuar, e qeni leh pa ndalë por prapë është i përcmar.
- Imam Shafiu
- Pjekuri do të thotë të dish të bësh gjëra, për të cilat nuk na kontrollon askush: të kesh lekë në xhep dhe të mos i shpenzosh ato, të të bien në qafë dhe të mos duash të

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

1	K	5	U	7	L	2	T	14	4	9	7	4	19
8	10	5		1	4	12	2	6	7	5		10	
10	4	7		4	1	2	8	10	6	4	7	5	
18				1	7	5	8	9	4	2	10	4	
6	5	1		6	2	10	5	2	5			12	
7	1			17	5		1	5	10	17	4	2	
2	5	10	17	4	2		4	10		6	15	5	
8	2	9	12		15		6	10	17	5			
18	10	5	16	19		6	4	8		10	1		
6		7	5		6	11	5		9	19	6	7	
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	17	6	
12	5	2	5		12	1	6	15	4	2		8	

M	A	S	H	U	R	K	A	I	R	A	K
E	S	T	E	R	A	D	H	U	N	A	
I	T	E	A	T	E	R	M	I	N		
E	R	A	P	O	L	A	R	T	A		
K	E	L	P	O	L	E	M	I	K	A	T
L	P	O	L	I	G	A	M	I			
E	T	A	P	I	K	A	T	R	E	L	
K	O	M	O	D	E	N	T	O	K	E	
T	R	I	S	E	T	M	N	U	N		
I	T	T	U	T	U	I	T	I	D		
K	A	D	E	T	K	O	S	H	L	E	
E	T	I	K	S	E	K	S	E	R	E	T

PËRGJIGJET E FJALËKRYEQVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

P	E	T	R	I	K	A	A	S	P	A	K
T	R	U	P	T	A	L	E	N	T	I	A
T	R	A	S	T	P	A	N	T	E	R	A
B	E	L	S	A	N	D	O	K	A	N	
B	A	K	U	N	I	N	A	N	E	M	
T	A	M	A	R	O	C	I	I	H		
P	I	E	E	N	A	O	D	R	E		
A	C	T	O	N	E	K	K	A	O	S	
R	A	T	R	A	D	E	A	L	M	A	
K	E	M	A	P	E	T	E	E	A	F	
E	L	S	A	V	A	L	R	O	N	E	
R	I	T	M	A	L	L	A	R	M	E	T

FJALËKRYQI (2)

M	A	B	U	S	E	H	A	N	E	T
O	R	E	K	S	B	D	E	M	O	N
R	A	S	T	K	A	B	I	R	E	T
I	B	A	P	E	R	I	T	O	N	E
A	I	K	I	M	B	O	I	R	K	
R	A	S	A	P	A	G	A	N	I	
T	A	V	E	R	R	A	D	O	M	
Y	M	A	R	S	I	A	N	E	T	I
M	A	J	A	F	O	R	M	A	T	
H	A	R	A	K	I	R	T	E	R	I
A	S	I	T	R	A	D	A	M	E	S
S	H	A	M	A	T	A	L	L	O	T



Thënie të mençura

- Une nuk di gjithcka
- une vetëm bëj gjithcka
- Toni Morrison**
- Nese nuk tregon te verteten per veten
- nuk mund te tresh dot as per te tjeret.
- Virginia Woolf**
- Vështirësitë kultivojnë te njeriu aftësi të domosdoshme për kapërcimin e tyre.
- (Filips)**
- Ka njerëz, të cilët nuk lajthisin kurrë sepse mendja e tyre nuk prodhon asnjëherë mendime të arsyeshme.
- {Gete}**

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

GSH

www.gsh.al

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

Tashmë edhe lundroni!

